



Task Forca për Integrim Evropian  
Task Forca za Evropske Integracije  
Task Force on European Integration

**Tryeza Tematike 6: MJEDISI, ENERGJIA, TRANSPORTI DHE ZHVILLIMI RAJONAL**

**MATERIAL DISKUTIMI PËR FUSHËN E ENERGJISË <sup>1</sup>**

**Dhjetor 2012**

---

<sup>1</sup> Ky material është hartuar me mbështetjen e “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH” përmes projektit “Mbështetje për Integrimin Evropian”. Qëndrimet, informatat dhe/apo argumentet nuk reflektojnë detyrimisht mendimin/qëndrimin e GIZ-it, MIE-s apo cilitdo nga pjesëmarrësit e TRT-së.

## **PERMBAJTJA**

### **1. Të përgjithshme**

- 1.1. Kërkesat e BE për sektorin e energjisë
- 1.2 Korniza ligjore
- 1.3 Korniza institucionale
- 1.4 Dokumentat strategjike

### **2. Siguria e Furnizimit**

### **3. Tregu i Brendshëm i Energjisë**

### **4. Energjia e Përtëritshme**

### **5. Efiçienca e Energjisë**

### **6. Siguria Nukleare dhe Mbrojtja nga Rrezatimi**

### **Bibliografia**

### **Shtojcat**

## 1. Të përgjithshme

Republika e Kosovës ka përgatitur një strategji gjithëpërfshirëse të energjisë në përputhje me *acquis* të BE-së dhe kërkesat për integrim Evropian. Kjo strategji synon arritjen e menaxhimit efektiv të burimeve energjetike ekzistuese dhe mbrojtjen e mjedisit. Ajo fokusohet në përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji në përputhje me standardet Evropiane, si edhe në diversifikimin e burimeve të energjisë. Ajo synon gjithashtu përdorimin racional të energjisë, nxitjen e efikasitetit të energjisë, promovimin e zhvillimit të burimeve të përtëritshme dhe futjen e teknologjive të reja që nuk shkaktojnë dëme të pariparueshme në mjedis, duke respektuar kështu aplikimin e standardeve ndërkombëtare të pranueshme mjedisore.

Republika e Kosovës synon integrimin në Bashkimin Evropian, i cili kërkon zbatimin e qasësve 20-20-20 për sektorin e energjisë të aplikueshme për vendet anëtare deri në vitin 2020, në mënyrë që të: (i) reduktohet emetimi i CO<sub>2</sub> me 20%, (ii) rritet me 20% përqindja e burimeve të përtëritshme në konsumin final të energjisë, dhe (iii) përmirësohet eficientia e energjisë me 20%.

Në 18 tetor 2012, Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë (KEN) adoptoi Strategjinë rajonale të Energjisë<sup>2</sup> për KEN. Ky është hapi i parë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit kost-eficient të infrastrukturës energjetike në rajon. Ai sjell bashkë strategjitë dhe planet nacionale të Palëve Kontraktuese me angazhimet ligjore ekzistuese të KEN në fushën e energjisë, konkurrencës dhe mjedisit.

Siguria e furnizimit me energji, sidomos me energji elektrike, është një ndër prioritetet e para të Qeverisë së Kosovës (QK). Furnizimi cilësor me energji konsiderohet mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Për këtë arsye, QK dhe komuniteti i donatoreve, përfshirë Komisionin Evropian, Bankën Botërore, USAID, KfW, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SADC) dhe disa donatorë të tjerë ndërkombëtar, në kuadër të një përpjekjeje të bashkërenduar, kanë punuar së bashku për të reformuar, ristrukturuar dhe financuar investimet me të domosdoshme në sektorin energjetik.

Kosova është e përkushtuar të zhvillojë tregje të hapura dhe konkurruese energjetike në përputhje me *acquis* të BE-së. Por nuk ka progres domethënës në këtë drejtim. QK duhet të marrë vendime të rëndësishme për të arritur këtë synim. Pa ndermarre hapa drejt krijimit të tregut konkurrues energjetik, do të jete praktikisht shumë e veshtire ose edhe e pamundur të tërhiqen investitorë privat strategjik për zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese nga linjiti<sup>3</sup> dhe hidroenergji<sup>4</sup> tashmë të planifikuara.

---

<sup>2</sup> Kjo Strategji përfshin të nënta Palët Kontraktuese të KEN: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovën, Moldavinë, Malin e Zi, Serbinë, dhe Ukrainën.

<sup>3</sup> Një proces tenderues për zhvillimin e Projektit Kosova e Re është duke u zhvilluar. Si është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ky projekt përfshin zhvillimin e një termo-elektro-centrali të ri (TEC) me deri 1,000 MW, zhvillimin e një miniere të re të linjtit në Sibovc, dhe rehabilitimin e TC Kosova B.

<sup>4</sup> Në fund të vitit 2009, Qeveria e Kosovës filloi procedurën e tenderimit për zhvillimin me investime private të një hidro-elektro-centrali (HEC) në Zhur me fuqi të instaluar prej 305 MW dhe prodhim prej rreth 400 GWh/vit.

Nga ana tjetër, zbatimi i caqeve 20-20-20 të BE-së deri në 2020 kërkon vëmendjen e veçantë të QK. Një numër i planeve janë zhvilluar, dhe disa projekte demonstrative, shumica të financuara nga donatorët si KE-ja, janë zbatuar ose janë duke u zbatuar, shumica e tyre në ndërtesat publike. Një total prej 35 milion Euro janë disponibël në mbështetje të zbatimit të masave të efijencës së energjisë në sektorët e amvisërisë dhe biznesit të vogël, si linja kredie komerciale prej KfW-së nëpërmjet të dy bankave komerciale vendore<sup>5</sup>.

Kosova është pjesë e perspektivës Evropiane të Ballkanit Perëndimor. Sa i përket kriterëve ekonomike, Kosova nuk ka bërë progres drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Nevojiten reforma dhe investime të konsiderueshme ashtu që ajo të mundet të përshtatet në periudhën afatgjatë me forcat e tregut dhe presionin konkurrues që ekzistojnë brenda Unionit. Kompania elektrike publike ka vazhduar të marrë subvencione substanciale nga buxheti i shtetit si dhe kredi për të financuar programin e saj të investimeve. Ka pasur disi progres në fushën legjislative sa i përket politikës të konkurrencës, në veçanti politikës antitrust si dhe ndihmën Shtetërore me adoptimin e ligjit për ndihmën Shtetërore. Zbatimi i politikës antitrust po përmirësohet<sup>6</sup>.

Në sektorin e energjisë, ka pasur disi progres në përafrimin e e legjislacionit dhe zbatimin e Traktatit për Komunitetin e Energjisë. Në mënyrë që të tërhiqen investime, nevojitet vazhdimi i përpjekjeve për përmirësimin e performancës me faturimin dhe inkasimin të energjisë elektrike, si dhe të vendosen tarifa kost-reflektive të pasubvencionuara. Termocentrali i planifikuar 'Kosova e Re' ka vuajtur nga vonesa. Kjo ka pasur një ndikim në orarin e paraparë për mbylljen e termocentralit mjaft ndotës Kosova A. Si pasojë e diferencave për statusin, Kosova po e ka të pamundur të marrë pjesë në mekanizmat rajonale të tranzitimit të energjisë. Kjo dëmton stabilitetin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës dhe shkakton humbje të ardhurash nga tranzitimi<sup>7</sup>.

### 1.1 Kërkesat e BE-së për sektorin e energjisë

Për Republikën e Kosovës, kërkesat e Bashkimit Evropian për sektorin e energjisë janë mandatar në Traktatin për Krijimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) ku Kosova merr pjesë si palë Kontraktues. Deri sot, KEn *acquis* përfshijnë legjislacionin kryesor të BE-së në fushat e energjisë elektrike, gazit, mjedisit, konkurrencës, burimeve të përtëritshme, efijencës së energjisë, naftës dhe statistikave. (Informacion hyrës i përmbledhur për TKE gjendet në Shtojcën 1.)

Një listë e plotë e *acquis te Be-së*, të cilat Kosova është e obliguar ti zbatojë në kuadër të TKE, vijon:

---

<sup>5</sup> Me rendësi është të shënohet se, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, normat e interesit të kredive për masat e efijencës së energjisë janë bukur të larta në Kosovë; ato luhaten prej 11% në 13%.

<sup>6</sup> Komunikimin prej Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012, Bruksel 12.10.2011

<sup>7</sup> Po aty...

Acquis për energjinë elektrike, përfshirë:

1. Direktiva 2009/72/EC e 13 korrikut 2009 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike
2. Rregulli (EC) Nr. 714/2009 të 13 korrikut 2009 mbi kushtet për kyçje në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike
3. Vendimin e Komisionit 2006/770/EC të 9 nëntorit 2006 mbi amendimin e Shtojcës së Rregullit (EC) Nr. 1228/2003 mbi kushtet për kyçje në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike
4. Direktiva 2005/89/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 janarit 2006 mbi masat për të garantuar sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe investimet në infrastrukturë
5. Direktiva 2003/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 qershorit 2003 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike
6. Rregulli 1228/2003/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 qershorit 2003 mbi kushtet për kyçje në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike

Acquis për gazin, përfshirë:

1. Direktiva 2009/73/EC e 13 korrikut 2009 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror
2. Rregulli (EC) Nr. 715/2009 i 13 korrikut 2009 mbi kushtet për kyçje në rrjetat transmetuese të gazit natyror
3. Rregulli (EC) Nr. 1775/2005 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të 28 shtatorit 2005 mbi kushtet për kyçje në rrjetat transmetuese të gazit natyror
4. Direktiva 2004/67/EC e 26 prillit 2004 mbi masat për të garantuar sigurinë e furnizimit të me gaz natyror
5. Direktiva 2003/55/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 korrikut 2003 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror

Acquis për mjedis, përfshirë:

1. Direktiva 2003/35/EC e 26 majit 2003 që parashikon pjesëmarrjen e publikut në dizajnimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin
2. Direktiva 2001/80/EC e 23 tetorit 2001 mbi kufizimin e emetimit të ndotësve të caktuar në ajër nga impjantet e mëdha djegëse
3. Direktiva 1999/32/EC e 26 prillit 1999 lidhur me reduktimin e përmbajtjes së sulfurit në karburante të caktuara të lëngëshme dhe amendimin e Direktivës 93/12/EEC
4. Direktiva 97/11/EC e 3 marsit 1997 që amendon Direktivën 85/337/EEC mbi vlerësimin e efekteve në mjedis nga projekte të caktuara private dhe publike

5. Direktiva 85/337/EEC e 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e efekteve efektive në mjedis nga projekte të caktuara private dhe publike
6. Direktiva 79/409/EEC e 2 prillit 1979 mbi mbrojtjen e zogjve të egër
7. Përpjekja për t'u antarësuar në Protokollin e Kiotos
8. Ndërtimi dhe operimi i centraleve të reja gjeneruese – pas hyrjes në fuqi të Traktatit duhet të jenë në përputhje me *acquis për mjedis*

Acquis për konkurrencë, përfshirë:

*Acquis* për konkurrencë<sup>8</sup> bazohen në tri shtylla:

- (i) Ndalimi i kartelevë sipas Nenit 81 të TKE
- (ii) Ndalimi i abuzimit me pozitë dominuese sipas Nenit të TKE
- (iii) Ndalimi i ndihmes Shtetërore sipas Nenit 87 të TKE.

Poashtu, aplikohen për Palët Kontraktuese parimet e TKE lidhur me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta speciale ose ekskluzive, në veçanti Neni 86(1) dhe (2) i TKE.

Acquis për burimet e përtëritshme, përfshirë:

1. Direktiva 2009/28/EC e 23 prillit 2009 mbi nxitjen e përdorimit të energjisë prej burimeve të përtëritshme
2. Direktiva 2003/30/EC e 8 majit 2003 mbi nxitjen e përdorimit të biokarburanteve ose karburanteve të tjera të përtëritshme në transport
3. Direktiva 2001/77/EC e 21 shtatorit 2001 mbi nxitjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e përtëritshme në tregun e brendshëm të energjisë elektrike

Acquis për eficientësinë e energjisë, përfshirë:

1. Rregulli i Deleguar nga Komisioni (BE) Nr. 1059/2010 i 28 shtatorit 2010 lidhur me etiketimin energjetik të enëlarëve shtëpiake
2. Rregulli i Deleguar nga Komisioni (BE) Nr. 1060/2010 i 28 shtatorit 2010 për etiketimin energjetik të pajisjeve frigoriferike shtëpiake
3. Rregulli i Deleguar nga Komisioni (BE) Nr. 1061/2010 i 28 shtatorit 2010 për etiketimin energjetik të makinave larëse shtëpiake
4. Rregulli i Deleguar nga Komisioni (BE) Nr. 1062/2010 i 28 shtatorit 2010 për etiketimin energjetik të televizoreve
5. Direktiva 2010/30/EU e 24 shtatorit 2010 mbi tregimin nepermjet etiketimit dhe informacionit standard të produktit i konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera prej produkteve që janë të lidhura me energjinë
6. Direktiva 2010/31/EU e 24 shtatorit 2010 mbi performancën energjetike të ndërtesave

<sup>8</sup> *Acquis* për konkurrencë duhet të zbatohen për sa i takon tregtimin të energjisë në rrjeta midis Palëve Kontraktuese.

7. Direktiva 2006/32/EC e 5 prillit 2006 mbi përdorimin fundor eficient të energjisë dhe shërbimet energjetike
8. Direktiva 2002/40/EC e 8 majit 2002 mbi etiketimin energjetik të sobave elektrike shtëpiake
9. Rregulli i Deleguar nga Komisioni (BE) Nr. 626/2011 i 22 marsit 2002 mbi etiketimin energjetik të kondicionerëve të ajrit
10. Direktiva 98/11/EC e 27 janarit 1998 mbi etiketimin energjetik të poçave ndriçues shtëpiake
11. Direktiva 96/60/EC e 19 shtatorit 1996 mbi etiketimin energjetik të larëveve-tharëve të kompinuara shtëpiake

Acquis për naftën, përfshirë:

1. Direktiva 2009/119/EC e 14 tetorit 2009 që detyron Vendet Anëtare të mbajnë rezerva minimale të naftës krudo dhe/ose produkteve të naftës

Acquis për statistikat, përfshirë:

1. Direktiva 2008/92/EC e 22 tetorit 2008 lidhur me një procedurë të Komunitetit për të përmirësuar transparencën e çmimeve të gazit dhe energjisë elektrike që u ngarkohen konsumatorëve fundorë industrial
2. Rregulli Nr. 1099/2008 i 22 tetorit 2008 mbi statistikat energjetike

Lidhur me emetimet, burimet e përtëritshme dhe eficiencën e energjisë, caqet e përgjithshme të Bashkimit Evropian (BE) për sektorin energjetik janë (përfshirë transportin) që deri në vitin 2020 të arrihet:

- (i) 20% reduktim i emetimeve të CO<sub>2</sub>,
- (ii) Rritje në nivelin 20% të pjesës së burimeve energjetike të ripërtëritshme (BRE) në konsumin final të energjisë, dhe
- (iii) Përmirësim me 20% të eficiencës së energjisë.

Kontributi individual i secilit shtet anëtar i BE në këto tri caqe të përgjithshme ndryshon në varesi të situatës aktuale të disa faktoreve si intensiteti i energjisë, GDP, aksesin dhe përdorimin e BRE, dhe mundësia e tyre për të kontribuar në caqet e përgjithshme.

Duke konsideruar situatën aktuale në Kosovë, dhe rritjen e shpejtë të kërkesës për ngrohje dhe energji elektrike, Kosova nuk do të jetë gati të arrijë targetin për reduktim me 20% të emetimit të CO<sub>2</sub> përpara vitit 2020<sup>9</sup>.

## 1.2 Korniza ligjore

Kosova ka bërë progres substancial me zhvillimin e legjislacionit dhe rregullave për sektorin energjetik në përputhje me *acquis* të BE-së, siq kërkohet në kuadër të TKE. Një listë e legjislacionit dhe rregullores kryesore vijon:

<sup>9</sup> Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018

#### A. Legjislacioni per energjinë

1. Ligji per Energjinë, Nr. 03/L-184, 15.11.2010
2. Ligji per Energjine Elektrike, Nr. 03/L-201, 15.11.2010
3. Ligji per Rregullatorin e Energjise, Nr. 03/L-185, 15.11.2010
4. Ligji per Gazin Natyror, Nr. 03/L-118, 02.11.2009
5. Ligji per Eficiencen e Energjise, Nr. 04/L-016, 22.07.2011
6. Ligji per Ngrohjen Qendrore, Nr. 03/L-116
7. Ligji per Miniera dhe Mineralet, Nr. 03-L-163, 27.10.2010
8. Ligji per Enët nën Presion, Nr. 02/L-103, 18.12.2006

#### B. Legjislacion tjere relevant

1. Ligji për Ndërmarrjet në Pronësi Publike, Nr. 03-L-087
2. Ligji për Planifikim Hapësinor, Nr. 2003-14
3. Ligji për Ujërat e Kosovës, Nr.2004/ 24
4. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03-L-025
5. Ligji për Tregtimin e Naftës dhe Produkteve të naftës, Nr. 2004/5
6. Ligji për Investimet e Huaja, Nr. 02-L-33
7. Ligji për Konkurrencën, Nr. 36/2004
8. Ligji për Shpronësimin dhe Pasurinë e Paluajtshme, Nr. 03-L-139
9. Ligji për Partneritetet Publike-Private, Nr. 04/L-045, 21.10.2011
10. Ligji për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Nukleare, Nr. 2011/04-L-067, dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Nr. DL-028-2012, datë 08.06.2012

#### C. Legjislacioni sekondar kryesor

1. Vendimi i Qeverisë për ristrukturimin e KEK sh.a., Nr 06/2005
2. Vendimi i Qeverisë për shturjen e KEK sh.a., Nr. 04/36, 2008
3. Vendimi i Qeverisë për krijimin e një Kompanie të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike, Nr. 03/38, 2008; dhe Privatizimi i saj nepermjet tenderimit publik, Nr. 03/38, 2008 and Nr. 08/39
4. Vendimi i Qeverisë për Politikën Pronësore për Ndermarrjet Publike Qendrore, Nr. 11/39 dhe Nr. 13/39
5. Udhëzimi Administrativ i Qeverisë së Kosovës për Nxjitjen e Përdorimit Eficient të Energjisë nga Konsumatorët Fundorë dhe Sherbimet Energjetike
6. Vendimi i Qeverisë mbi mundësinë e zhvillimit të Hidrocentralit në Zhur, Nr. 02/40 2008
7. Rregulli për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese. Linjat e Gazit, Linjat Direkte Elektrike, dhe Tubacionet Direkte të Gazit.



### 1.3 Korniza institucionale

Institucionet e sektorit energjetik përfshijnë institucionet qeveritare, institucionet rregullatore, dhe një numër ndermarrjesh energjetike. Institucionet kryesore përfshijnë Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Zyren e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM); ndërsa ndermarrjet kryesore energjetike janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), Operatori i Kosovës i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT sh.a.), Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS sh.a.), dhe tri kompanite e ngrohjes qendrore (Prishtina, Gjakova and Mitrovica).

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) është krijuar me Rezolutën Nr. 218 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 24.02.2011; bazuar në Rregullin Qeveritar Nr. 02/2011 mbi fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrive.

MZhE është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin ekonomik; monitorimin e ndermarrjeve në pronësi publike; përgatitjen dhe zbatimin e politikave/dokumenteve strategjike për sektorin e energjisë, sektorin minier, shërbimet postare, sektorin e telekomunikacionit dhe sektorin e teknologjisë së informacionit. Në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, MZhE përpilon bilanci energjetik të vendit, dhe politikën dhe planet për eficiencën e energjisë dhe burimet e përteritshme. Ajo bashkëpunon me komunitetin e biznesit dhe asociacionet e biznesit me synim krijimin e një mjedisi tërheqës biznesor.

2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) u krijua në vitin 2004, nëpërmjet Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/09, si një autoritet rregullator i pavarur për sektorin e energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit natyror. ZRRë është përgjegjëse për adoptimin e tarifave, dënimin e autorizimeve për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, monitorimin e tregjeve të energjisë dhe përgatitjen dhe/ose adoptimin e rregullave për sektorin energjetik, përfshirë kodet dhe rregulloret respektive. Është në mandatin e ZRRë të sigurojë që siguri të 'furnizuesit publik' plotëson të gjitha 'obligimet për furnizim' me energji të gjithë konsumatorëve në mënyrë të qëndrueshme dhe me çmime që reflektojnë kostot. ZRRë siguron transparencën dhe përgjegjësinë nga aktorët e tregut energjetik dhe është e angazhuar në përmirësimin e performancës së tyre ekonomike, sociale dhe mjedisore. Objektivi kryesor i ZRRë është që të vendosë kornizën rregullatore për një treg të energjisë transparent dhe jodiskriminues bazuar në parimet e tregut të lirë, si dhe të nxisë konkurrencën.

3. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është krijuar në janar 2005 nga Rregullorja 2005/2 e UNMIK-ut – duke përfaqësuar kështu "Agjencinë Rregullatore të Pavarur" për sektorin minier. KPMM është përgjegjëse për dënimin e licencave për hulumtimin dhe shfrytëzimin përfshirë linjatin. Ai është poashtu përgjegjës për mbikqyrjen e licencave të leshuara. Aktualisht, KPMM funksionon në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale Nr.03/L-163 të 27 gushtit 2010.

Institucione të tjera qeveritare, si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Punës dhe Mireqenies Sociale (MPMS), Ministria e Tregtisë dhe

Industrija (MTI) dhe Ministria e Financave (MF), luajnë rol të rëndësishëm në play important roles in mbikqyrjen e përgjegjësi sociale, ekonomike dhe mjedisore të sektorit energjetik.

*Ndërmarrjet kryesore energjetike përfshijnë:*

1. Operatori i Kosovës i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT sh.a.) u krijua në vitin 2006, në përputhje me kërkesat për shthurje sipas Ligjit për Energji dhe kërkesat e TKE. KOSTT sh.a. si kompani në pronësi publike është përgjegjës për operimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe interkoneksioneve të tij me sistemet e vendeve fqinje. Poashtu, KOSTT sh.a. është përgjegjës për funksionimin dhe operimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë. Burimi kryesor i të ardhurave për KOSTT sh.a. është tarifa e transmetimit që paguhet prej KEK sh.a., siç ajo vendoset nga ZRrE.

2. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.) është kompania në pronësi publike që posedon dhe operon asetet e gjenerimit dhe shpërndarjen e energjisë elektrike<sup>10</sup>, si dhe asetet e mihjes së linjitet. Performancat e saj operacionale dhe financiare nuk kanë qenë të kënaqshme gjatë periudhës 1999-2012, edhe pse njëfarë progresi është arritur gjatë pak viteve të fundit. Gjatë pjesës më të madhe të periudhës së pas-luftës KEK sh.a. është menaxhuar dhe asistuar nga konsulenca të huaja. Qëndrueshmëria financiare e KEK sh.a. nuk është arritur akoma. Cilësia e ulet e furnizimit me energji elektrike është problemi kryesor në Kosovë.

3. Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KKDFE sh.a.)<sup>11</sup> është një kompani e inkuorporuar nga KEK sh.a. Siç janë dakorduar Qeveria e Kosovës (QK) dhe një investitor privat në 17 tetor 2012, KEK sh.a. do të transferojë (brenda 6 muajve) KEDS sh.a.-së biznesin e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. QK është dakorduar poashtu të shesë investitorit privat 100% të aksioneve të KEDS sh.a.

4. Kompanitë e Ngrohjes Qendrore (NQ) ekzistojnë në Prishtinë, Gjakovë, dhe Mitrovicë. Gjenerimi total i nxehtësisë prej tyre arrin në rreth 130 GWh<sub>t</sub>/vit, që përfaqëson rreth 3% të kërkesës totale për ngrohje në Kosovë. Kompanitë e ngrohjes qendrore furnizojnë pjesët më të populluara të qyteteve përfshirë banesat, spitale, shkolla dhe ndërtesa administrative<sup>12</sup>. Sistemi NQ i Prishtinës përbën mbi 80% të kapacitetit total të NQ në Kosovë. Ai operohet nga Termokos sh.a., një kompani komunale publike. Të tria kompanitë e NQ vuajnë nga humbje mjaft të larta komerciale.

---

<sup>10</sup> Divizionet e Shpërndarjes dhe Furnizimit të KEK sh.a. janë privatizuar. Kontrata e privatizimit është nënshkruar në 17 tetor 2012.

<sup>11</sup> KKDFE (Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a.) është kompani e inkuorporuar në Kosovë me numrin e regjistrimit 70606119, me zyrë të regjistruar në Nr.3, Bulevardi Bill Clinton, Prishtinë, Republika e Kosovës.

<sup>12</sup> Të tria sistemet e NQ prodhojnë vetëm nxehtësi; ato nuk furnizojnë ujë të ngrohtë sanitar. Si rezultat, këto sisteme operojnë vetëm gjatë sezonit të ngrohjes.

## 1.4 Dokumentat strategjike

Dokumentet kryesore strategjike lidhur me sektorin energjetik ne Kosove përfshijnë:

1. Strategjinë e Energjisë te Republikës se Kosovës 2009-2018
2. Strategjinë e Ngrohjes te Republikës se Kosovës 2011-2018
3. Strategjinë e Minerare te Republikës se Kosovës 2012-2025 (aq sa i përket linjtit për gjenerim te energjisë elektrike)
4. Programi i Zbatimit te Strategjisë se Energjisë 2009-2011
5. Plani Nacional i Veprimit për Eficiencen e Energjisë 2010-2018
6. Plani Kosovar i Thjeshtuar i Veprimit për Burimet e Përsëritshme, dorëzuar Sekretariatit te TKE në 2011

Dokumente te tjera te rëndësishme përfshijnë: (i) bilancet energjetike vjetore te Republikës së Kosovës për vitet 2003-2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011; dhe (ii) parashikimet vjetore dhe afatgjata te kërkesave për energji te përgatitura gjate periudhës 2007-2012.

\*  
\* \*


Seksionet ne vijim te këtij raporti diagnostik janë menduar te ofrojnë (i) informacion për statusin dhe progresin e arritur deri më tani me reformat, ristrukturimin dhe zhvillimin e sektorit energjetik në Kosovë, (ii) analizë te praktikave më te mira ne vende te tjera, dhe (iii) identifikim te sfidave kryesore dhe një rruge te propozuar drejt arritjes se qëllimit për integrim Evropian.

## 2 Siguria e Furnizimit

### A. Gjendja, progresi dhe planet

Pas luftës se vitit 1999, prodhimi vendor i energjisë elektrike nuk ka mundur te përballojë kërkesën për **energji elektrike** në Kosovë. Si pasojë është aplikuar dhe vazhdon te zbatohet kufizimi i planifikuar (ne përputhje me një skeme te paracaktuar) i furnizimit me energji, veçanërisht gjate periudhave kur importimi është i pamundur ose gjate orëve te pikut kur kapacitetet e limituara transmetuese nuk lejojnë mbulimin e ngarkesës.

Grafiku në vijim tregon paraqet balancën mes prodhimit vendor dhe konsumit te energjisë elektrike. Duket që Kosova ka qenë një importues neto i energjisë elektrike gjate dekadës 2000-2010<sup>13</sup>. Importimi neto i mesatarizuar gjate 2000-2010 ka qenë ne nivelin e 10% te konsumit total te realizuar.



Vlerësimi më i fundit i Komisionit Evropian (KE) për sigurinë e furnizimit me energji ne Kosove ipet i përmbledhur ne kuadratin ne vijim.

#### Siguria e Furnizimit: Vlerësimi i KE në 2011

Nuk ka pasur zhvillim lidhur me **sigurinë e furnizimit**. Kosova akoma nuk ka strategji për te arritur nivelin e kërkuar te rezervave te naftës. Zbatimi i investimeve dhe mirëmbajtja ne përputhje me planin zhvillimor te sistemit te transmetimit për periudhën 2010-2019 e kanë bërë sistemin e transmetimit te Kosovës më te besueshëm. Si pasoje e diferencave mbi statusin e tij, operatori i sistemit te transmetimit të Kosovës akoma nuk merr pjese ne mekanizmat rajonale që te planifikoje dhe përfitoje nga tranzitimi i energjisë elektrike. Si rezultat i mungesës se kontrollit mbi të dëmtohet stabiliteti i sistemin te transmetimit te energjisë elektrike te Kosovës dhe ajo humbet te ardhura nga tranzitimi.

Sektori energjetik vazhdon te vuaje nga probleme serioze. Ndërprerjet e energjisë vazhdojnë te jenë prezent si konsekuencë e gjendjes së vështirë financiare te korporatës energjetike te shkaktuar nga vështirësitë me faturimin dhe inkasimin e energjisë elektrike.

*Burimi:* Dokumenti Punues i Stafit te Komisionit, Kosova\*, 2011; Raport Progresi, Bruksel, 12.10.2011

<sup>13</sup> Deklarata e Sigurisë së Furnizimit për Kosovën (Energji elektrike, Gaz Natyror dhe Naftë), ZRrE, korrik 2011

Rreth 97% e kapaciteteve gjeneruese te energjisë elektrike në Kosovë ndodhen ne dy termoelektrocentralet (TEC) e KEK sh.a.: Kosova A (5 njësi) dhe Kosova B (2 njësi). Fuqia totale e instaluar për te dy këto TEC-e është 1,478 MW. Nëse i gjithë ky kapacitet do te ishte i shfrytëzueshëm, do te ishte i mjaftueshëm për te përballuar kërkesën aktuale për energji elektrike në Kosovë. Kapacitetet gjeneruese operues ne Kosove përfshijnë: (i) tri njësi te Kosova A dhe dy njësi te Kosova B, me kapacitet total prodhimi prej 860 MW; (ii) dy hidroturbina në Ujman me kapacitet total te instaluar prej 35 MW; dhe (iii) disa hidrocentrale te vogla (HCV) me fuqi totale te instaluar prej 11.68 MW<sup>14</sup>. Operon ne Kosove edhe një ferme e vogël me mullinj me erë në Golesh me kapacitet te instaluar prej 1.35 MW. Kështu, kapaciteti total gjenerues në dispozicion në Kosove është pak më shumë se 900 MW.

Sistemi i transmetimit te Kosovës është i lidhur ne nivelin 40 kV me te gjitha sistemet fqinje, përveç interkoneksionit me Shqipërinë që është në nivelin 22 kV. Ndërtimi i një linje te re interkoneksioni me Shqipërinë është prioritet. Kjo linje do te lejonte shtimin e shkëmbimeve energjetike ndërshtetërore dhe do te mundësonte optimizimin e gjenerimit te energjisë elektrike midis dy vendeve – Kosovës që ka bazë ka bazë gjeneruese kryesisht prej linjitet dhe Shqipërisë që e ka hidro. Kjo linje 400 kV do te mundësonte shtimin e ndjeshëm te shkëmbimeve te energjisë elektrike ne nivel rajonal. Strategjia e Energjisë e Kosovës 2009-2018 parasheh edhe nevojën për fillimin e aktiviteteve te kërkuara për ndërtimin e një linje te dyte interkoneksioni 400 kV me Republikën e Maqedonisë.

Siguria e furnizimit me energji ka qenë mes prioriteteve kryesore te Qeverise se Kosovës (QK) dhe te kompanisë nacionale energjetike KEK sh.a. Për këtë, është punuar në një numër drejtimesh dhe janë kryer disa veprime konkrete te rëndësishme. Ato përfshijnë:

1. Përgatitjen për ndërtimin me investime private te një termoelektrocentrali me 100 MW kapacitet te instaluar, i quajtur Projekti Kosova e Re. Rehabilitimi i TC Kosova B dhe zhvillimi i mëtejshëm i mihjes te linjitet në Sibovc janë dy komponentët e tjera te këtij Projekti.
2. Zhvillimi i një mihje te re te linjitet në Sibovcin Jugperëndimor për te siguruar furnizim te pandërprerë me linjitet te kapaciteteve gjeneruese ekzistuese. Aktualisht, kjo miniere prodhon linjitet.
3. Përgatitjen për ndërtimin e hidrocentralit (HC) në Zhur me 305 MW fuqi te instaluar, i cili pritet te gjeneroje afërsisht 400 GWh/vit.
4. Riparime te thella, mirëmbajtje dhe investime kapitale janë kryer në termocentralet ekzistuese TC Kosova A<sup>15</sup> dhe TC Kosova B.

---

<sup>14</sup> Të dhënat prej Bilancit te Energjisë të Republikës së Kosovës për vitin 2011. Hidrocentralet e vogla (HCV) përfshijnë Lumbardhin me 8.08MW, Radavcin me 0.9MW, Istogu me 0.854MW, Dikanci me 1.0MW, dhe Burimi me 0.854MW.

<sup>15</sup> Sipas Direktivës Evropiane për Centralet e Mëdha Djegëse, TC Kosova A mund te shfrytëzohet deri në fund te vitit 2017. Koha e saktë e dekomisionimit për te gjitha njesitë e TC Kosova A, para fundit te vitit 2017, do te varet nga koha e komisionimit te njësive te TC Kosova e Re.

5. Investime kapitale për zhvillimin e sistemit të transmetimit, përfshirë kryerjen e procesit përgatitor për ndërtimin e një linje të re interkoneksioni 400 kV me Shqipërinë<sup>16</sup>.
6. Janë identifikuar një numër i HCV-ve dhe ka filluar procesi përgatitor për zhvillimin e tyre. Një skenar baze për zhvillimin e burimeve të ripërtërishme parasheh ndërtimin e një numri të madh të HCV-ve me kapacitet që arrijnë në 140.3 MW deri në 2020<sup>17</sup>.
7. Zhvillimi i një numri të fermave të erës është në rend. ZRrE po kryen procedurat e autorizimit.

Përveç sa më sipër, QK ka subvencionuar në vazhdimësi importimin e energjisë elektrike në vitet e kaluara. Por të gjitha këto masa nuk kanë arritur akoma të sigurojnë nivel të kënaqshëm të furnizimit me energji elektrike. Regjimi i kufizimeve të furnizimit është zbatuar shpesh, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit. Kapacitet importues/eksportues i sistemit të transmetimit është rreth 450MW aktualisht. Importi i energjisë elektrike ka rezultuar të jetë relativisht i shtrenjtë në vitet e kaluara, dhe sigurisht që mund të jetë më i shtrenjtë në të ardhmen si rezultat i mungesës së konsiderueshme të kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike në rajon.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizim janë shumë të larta. Bashkë me humbjet teknike në rrjet, vjedhja e energjisë elektrike ka efekt përkeqësues në operimin ditor të KEK sh.a. Humbjet e larta komerciale (ose vjedhja e energjisë elektrike) përbën problemin kryesor për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e sektorit elektroenergjetik në Kosovë; që ndikon direkt në përgjithësi ekonominë e vendit<sup>18</sup>.

Furnizimi i mjaftueshëm i **produkteve të naftës** është një komponent tjetër i rëndësishëm i sigurisë energjetike. Të gjitha produktet e naftës që konsumohen në Kosovë vijnë nga importi. Zyra për Licencim, Rregullim, dhe Monitorim të Sektorit të Naftës është autoriteti përgjegjës për sektorin e naftës në Kosovë. Kjo Zyrë i raporton direkt Ministrin të Tregtisë dhe Industrisë, ashtu siç autorizohet nga Ligji Nr.03/L 138 për Licencimin, Rregullimin dhe Monitorimin e Sektorit të Naftës në Kosovë, datë 01.01.2010. Në përputhje me këtë Ligj, të gjitha stacionet e stokimit dhe shitjes së produkteve të naftës janë të detyruara të mbajnë të paktën 5% rezervë të produkteve të tyre për qëllime të emergjencës shtetërore. Ky Ligj nuk është në përputhje të plotë me *acquis* relevante të BE, veçanërisht lidhur me rezervën emergjente të naftës. Një ligj i ri për Sektorin e Naftës po draftohet. Ai pritet të miratohet gjatë muajve të parë të vitit 2013.

---

<sup>16</sup> Të gjitha studimet për këtë linjë interkoneksioni janë kryer. KfW e Gjermanisë ka angazhuar fondet për zbatimin e këtij projekti. Procesit tenderues është në fazë të avancuar.

<sup>17</sup> Deklarata e Sigurisë së Furnizimit për Kosovën (Energji elektrike, Gaz Natyror dhe Naftë), ZRrE, korrik 2011

<sup>18</sup> Në vitin 2010, humbjet teknike dhe komerciale arrinin në rreth 40% të energjisë të futur në sistemin energjetik të vendit. Raporti i ZRrE "Deklarata e Sigurisë së Furnizimit për Kosovën (Energji elektrike, Gaz Natyror dhe Naftë), korrik 2011" shënon se humbjet komerciale arrinin në 24.02%, humbjet teknike në shpërndarje arrinin në 17.2%, dhe humbjet teknike në transmetim ishin 2.38% (ose në total rreth 2,000 GWh) e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë në 2010.

Stoqet e naftës ne Kosove akoma nuk arrijnë kërkesat e BE-se siç ato definoohen nga Direktiva për Naftën 2009/119/EC. Ndërtimi i kapaciteteve stokuese shtese dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese do te kërkojë investime substanciale, dhe realizimi i plote i tyre mund te marrë një periudhë te gjatë. Studimi Rajonal për Stokun e Naftës, i komisionuar nga Sekretariati i TKE-se në 2010, tregon që kosto totale për arritjen e 90 ditëve stok emergjent te naftës dhe kërkesave te tjera te Direktivës 2009/119/EC ne Kosove, përfshirë koston e investimeve dhe shpenzimeve për zgjerimin e sasisë së stokuar te produkteve te naftës, arrin në rreth 157,000 milion Euro gjate periudhës 2011-2021. Për ketë arsye, Komuniteti i Energjisë po promovon një qasje rajonale ose nën-rajonale, që nënkupton që dy ose më shume vende te Ballkanit Perëndimor te zhvillojnë kapacitete te përbashkëta stokuese te naftës dhe gazit për te arritur plotësimin e kërkesave te Direktivës 2009/119/EC në te ardhmen.

**Gazi i lëngëzuar i naftës (GLN)** i importuar përdoret për gatim, dhe ngrohje te hapësirave në ndërtesat jo-rezidenciale. Infrastruktura për transport, stokim, dhe tregtim me pakicë të GLN është e kufizuar por qe po zgjerohet shpejt. GLN, nëpërmjet përdorimit te stufave te lehta deri tek kazanët/bojlerët për ngrohje qendrore, është eficient, i pastër, dhe i sigurte për ngrohje te hapësirave te vogla e te mëdha.

Kosova nuk është e lidhur me rrjetat operuese te **gazit natyror**. Një lidhje me furnizimin e gazit natyror do te ishte opsion i rëndësishëm për diversifikimin e furnizimit te vendit me karburante, si dhe për te rritur sigurinë e furnizimit. Linja e asistencës Evropiane “Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor (KIBP)” po mbështet shumë projekte që janë te lidhura me gazifikimin e Rajonit te Ballkanit. Këto përfshijnë tubacionin e gazit Ionian-Adriatik, dhe projekte te tjera rajonale që janë pjese e konceptit te BE-së për ‘Unazën e Gazit’ në Ballkanin Perëndimor. Kalimi në gaz, prej energjisë elektrike ose karburantet e tjera fosile veçanërisht për ngrohje, çon në një përdorim më eficient te një burimi më te pastër.

Në 18 tetor 2012, Këshilli Ministror i Komunitetit te Energjisë (KEN) adoptoi Strategjinë rajonale te Energjisë për KEn. Ky është hapi i parë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit kost-eficient te infrastrukturës energjetike në rajon. Ai sjell bashkë strategjitë dhe planet nacionale te Palëve Kontraktuese me angazhimet ligjore ekzistuese te KEn në fushën e energjisë, konkurrencës dhe mjedisit. Objektivat e kësaj Strategjie paraqiten në Shtojcën 2.

Strategjia Rajonale e Energjisë e KEn shënon poashtu se nëse trendët e shkuara vazhdojnë edhe ne te ardhmen, KEn do te ballafaqohet me një furnizim me mungesa serioze ne rritje, veçanërisht për energjinë elektrike; dhe këto mungesa do te ndikojnë negativisht në mundësinë e Palëve Kontraktuese (përfshirë Kosovën) për te arritur rritje ekonomike optimale. Poashtu, impaktet sociale dhe mjedisore të shoqëruara me përgjigje jo-adekuate ndaj këtyre sfidave do te jenë përkeqësuese dhe do te zvogëlojnë ndjeshëm aftësinë e rajonit për te arritur në mënyrë te qëndrueshme indikatorët e tij te zhvillimit.

Në Shtojcë 3 përmbledhen barrierat ndaj investime ne sektorin e energjisë te Ballkanit Perëndimor.

## **B. Sfidat kryesore për përmirësimin e sigurisë së furnizimit në Kosovë: Rruga përpara**

Zhvillimi i infrastrukturës energjetike. Siguria e furnizimit vazhdon të jetë sfida kryesore me të cilën përballë sektori energjetik në Kosovë. Përmirësimi i sigurisë energjetike nënkupton, mes të tjerave, nxitjen e diversitetit, efciencës dhe fleksibilitetit brenda sektorit energjetik, ashtu që Kosova të mundet të përgjigjet emergjencave energjetike. Në mënyrë që të arrihet një nivel i qëndrueshëm i sigurisë energjetike, Kosova duhet të avancojë infrastrukturën energjetike përfshirë kapacitetet gjeneruese dhe rrjetin transmetues. Zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga linjiti dhe interkoneksioneve të reja me vendet fqinje, përfshirë Shqipërinë dhe Maqedoninë, janë ndër prioritetet kryesore. Modernizimi dhe zgjerimi i kapacitetit në NQ Termokos dhe lidhja e saj me bashkeprodhimin në TC Kosova B përbën prioritet në sektorin ngrohjes qendrore.

Mundësimi pa vonesa i investimeve në furnizimin e energjisë. Siguria energjetike është e lidhur ngushtë me kryerjen në kohë të investimeve për furnizim të energjisë në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe mjedisit. Infrastruktura e rrjetit është kryesisht e vjetruar dhe duhet të përmirësohet në mënyrë që të mundet të ofroje siguri me të mirë furnizimi. Kjo do të kërkojë jo vetëm një shfrytëzim me eficient të sistemit ekzistues, por edhe investime të reja si në gjenerim ashtu edhe në infrastrukturën e rrjetit. Plane të detajuara të investimeve kapitale janë tashmë identifikuar për nën-sektorët e gjenerimit dhe transmetimit. Sfida është që ato të zbatohen sipas orareve kohore të parapara. (Shtojca 4 paraqet Parashikimin e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë sipas burimit energjetik primar deri në vitin 2030.)

Identifikimi dhe zhvillimi i skemave financiare inovative për investimet kapitale. Ekonomia dhe sektori financiar botëror ballafaqohet aktualisht me vështirësi. Norma e rritjes ekonomike është ngadalësuar kudo në botë. Sfidat për tërheqje të investimeve kapitale të mëdha janë shtuar. Tërheqja e investimeve kapitaleve të mëdha private në sektorin energjetik të Ballkanit Perëndimor ka rezultuar gati e pamundur në të shkuarën e afërt. Përballë kësaj situatë, Qeverisë së Kosovës (QK) mund ti duhet të konsiderojë fillimin e negociatave formale me bankat zhvillimore ndërkombëtare dhe komunitetin e donatorëve, që aktivisht veprojnë në sektorin energjetik të Kosovës, për të identifikuar skema inovative financimi që do të mundësonin realizimin e investimeve të mëdha të nevojshme në sektorin energjetik. Përzjerja e investimeve publike, atyre nga donatorët dhe atyre prej sektorit privat mund të ishte një opsion në rrugën drejt tërheqjes së këtyre investimeve në periudhën afatshkurtër deri afatmesme.

Aplikimi i cimeve të energjisë që reflektojnë kostot. Ecja në rrugën e liberalizimit të çmimit është domosdoshmëri për investime kapitale të suksesshme, sidomos të atyre private. Strategjia Rajonale Energjetike e KEn shënon se niveli ekzistues i çmimeve (jo plotësisht kost-reflektive) në Palët Kontraktuese (përfshirë Kosovën – shënimi është yni) nuk mund të mbështesë investimet e reja në gjenerim – si ato nëpërmjet tërheqjes së investitorëve private ashtu edhe ato prej mjeteve vetanake të kompanive energjetike vendore. Kur nivelet e çmimeve janë nën kostot e investimeve të reja, nuk do të jete e mundur të tërhiqen investime të reja mbi baza komerciale, të cilat nëse ndodhin do mund ta përkeqësonin balancën furnizim-kërkesë. Nëse



investimet mbeten te pamjaftueshme në periudhën afatgjate, ekziston një rrezik serioz për sigurinë e furnizimit, për te cilat çmimet e ulta te rregulluara do te ishin arsyeja kryesore.

Stoku emergjent i naftës. Një strategji për zbatimin e Direktivës 2009/119/EC është e nevojshme<sup>19</sup>. Ndërkohë duhet te zhvillohet një kornize ligjore për akumulimin e rezervës emergjente me naftë, si dhe te krijohen procedura dhe planifikim i përshtatshëm për përballim te emergjencave në përputhje me Direktivën 2009/119/EC.

Adoptimi i një modeli tregu energjetik qe mundëson konkurrencën është parakusht për investime te suksesshme ne sektorin energjetik.

### 3. Tregu i Brendshëm i Energjisë

#### A. Statusi, progresi dhe planet

Edhe pse legjislacioni për sektorin e energjisë dhe Strategjia e Energjisë 2009-2018 synojnë vendosjen e konkurrencës ne tregjet e energjisë sa me shpejt qe kjo te jete e mundur, pak progres është arritur ne këtë drejtim. Aktualisht, tregu i energjisë elektrike në Kosove dominohet nga KEK sh.a. Nuk ka konkurrencë ne tregun elektroenergjetik, përfshirë ato me shumicë dhe pakicë. Privatizimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit te energjisë elektrike nuk pritet te mundësojë ndonjë lloj te konkurrencës ne te ardhmen e parashikueshme. Një monopol publik vetëm se i është transferuar sektorit privat.

Edhe pse nuk ka ndonjë kufizim ligjor ndaj hyrjes ne treg te gjeneruesve apo furnizuesve te rinj, tregu i energjisë elektrike ne Kosove funksionon efektivisht si një “model me blerës te vetëm”<sup>20</sup>. Ky model nuk është ne përputhje me *acquis* te BE-së për energji. Kosova parashikon aplikimin e modelit te tregut me kontrata dypalëshe shoqëruar me një mekanizëm balancues. Tregu plotësisht konkurrues mbetet për tu zhvilluar. Aktualisht po përdoret një grup rregullash te përkohshme te tregut, por ato nuk aplikojnë ngarkesat për inbalanca dhe kontratat dypalëshe nuk janë akoma ne përdorim.

Sistemi i transmetimit është tashme i pavarur nga gjenerimi dhe shpërndarja. Sa i përket kyçjes ne rrjet (transmetim dhe shpërndarje), Kosova ka zgjedhur sistemin e kyçjes së rregulluar te palës së tretë. Licencat e KEK sh.a. JSC te lëshuara nga ZRrE kanë/detyrojnë tashmë që llogarite midis bizneseve te KEK-ut (gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit) te jene te shthurura. Në 2009, QK vendosi te shthurë/ndajë ligjërisht bizneset e Shpërndarjes dhe Furnizimit nga KEK sh.a.

---

<sup>19</sup> Për te arritur plotësimin e kërkesave te direktivës Kosova duhet te ndertojë kapacitete te konsiderueshme akumuluese. Per ta plotesuar obligimin deri në vitin 2020, Sekretariati i TKE-së i ka propozuar Kosovës një roadmap.

<sup>20</sup> “Politika për Energjinë e Ripërteritshme dhe Zhvillimet e Tregut në Kosovë”, Nustret Avdiu dhe Ali Hamiti, ZRrE, prill 2011, Kosovë

### Progresi i Kosovës me Tregun e Brendshëm Energjetik gjatë 2011

Disi progres është arritur lidhur me **tregun e brendshëm energjetik** dhe zbatimin e Traktatit për Komunitetin e Energjisë. Në tetor, Kuvendi adoptoi legjislacionin për energji, përfshirë ligjet për energji, energji elektrike dhe rregullatorin e energjisë për te përshtatur me tej Kosovën me pakon e dyte te tregut te brendshëm te energjisë në BE.

Ka vazhduar puna për zhvillimin e centralit te ri me linjit te Kosovës. Një kërkesë finale për propozime i është dërguar katër ofertuesve te parazgjedhur. Në fund te 2010, ka filluar shfrytëzimi i qymyrit në Mihjen e Sibovcit, e cila do ti ofrohet investitorëve si pjesë e TC Kosova e Re. Vështirësitë lidhur me shpronësimin e bëjnë te pamundur zbulimin e masës së duhur te qymyrit, duke venë kështu në rrezik furnizimin me qymyr te termocentraleve ekzistuese në te ardhmen e afërt.

Akoma nuk është kryer shthurja ligjore e funksioneve te shpërndarjes dhe furnizimit prej KEK sh.a., edhe pse ky obligim rrjedh nga legjislacioni vendor dhe Traktati për Komunitetin e Energjisë. Privatizimi i funksioneve te shpërndarjes dhe furnizimit të KEK sh.a. mbetet për t'u përfunduar.

Deri në përfundimin e Projektit Kosova e Re, funksionet e tjera mbeten te integruara ne KEK sh.a. Ndërmarrja elektroenergjetike e Serbisë mban një dege te palicencuar te saj ne Kosove. Si rezultat, Kosova nuk arrin te kontrolloje rrjetin e saj, gjë që e deprivon KEK sh.a. nga te ardhurat, veçanërisht sepse energjia elektrike devijohet nga Hidrocentrali Gazivoda për te furnizuar veriun.

Si pasoje e rënies së çmimeve te importit dhe subvencioneve te vazhdueshme te Qeverise për KEK sh.a., ZRRë ka mbajtur tarifat ekzistuese te energjisë elektrike. Duke pasur parasysh privatizimin e funksioneve te shpërndarjes dhe furnizimit te KEK sh.a. si dhe që tarifat te reflektojnë kostot aktuale, një rritje graduale e tarifave është e paevitueshme.

Si rezultat i investimeve, humbjet në sistemin e transmetimit janë zvogëluar. Nivelet e ulta te inkasimit (dhe tarifat jo kost-reflektive) vazhdojnë te nxisin një rritje te papërbalueshme te kërkesës për energji elektrike.

*Burimi:* Dokumenti Punues i Stafit te Komisionit, Kosova\*, 2011; Raport Progresi, Bruksel, 12.10.2011

Kosova ka përmirësuar kohet e fundit kornizën e saj ligjore dhe një model i ri i tregut është ne pritje te adoptohet si bazë për rregullat e reja te tregut. Sthurja e KEK sh.a. është ne progres për te ndodhur njëherësh me privatizimin e shërbimeve te shpërndarjes dhe furnizimit të KKDFE. Dominimi i tregut është aktualisht inherent dhe masat e ndërmarra për te tërhequr investime te reja vështirë te jenë eficiente ne periudhën afatshkurtër. Statusi i KOSTT në kontekstin e anëtarësimit në ENTSO-e është akoma i pazgjidhur<sup>21</sup>.

Struktura jo-adekuate e tregut te energjisë elektrike dhe mungesa e konkurrencës identifikohen shpesh si pengesa kryesore për investime private ne sektorin energjetik. Struktura e tregut te energjisë elektrike në Shqipëri, ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë, Ukrainë dhe Kosovë nuk favorizon zhvillimin e konkurrencës në tregjet me shumicë dhe pakicë dhe pakicë ne Palët Kontraktuese sepse<sup>22</sup>:

<sup>21</sup> Veprime Lokale si parakusht për hapjen e Tregut Rajonal me Shumicë – *Sfidat dhe Progresi i arritur*, Komuniteti i Energjisë – Forumi i 17-te i Athines, 27 – 28 qershor 2012

<sup>22</sup> “Çmimet e Rregulluara te Energjisë Elektrike në Komunitetin e Energjisë – Gjendja dhe Rekomandime për Reforma”, një Raport nga Sekretariati i Komunitetit te Energjisë, 25 qershor 2012

Së pari, duke kërkuar nga gjeneruesit ekzistues vendorë që të shesin për nevojat e konsumatoreve tarifore të gjithë energjinë elektrike që ata gjenerojnë, nuk mbetet energji e prodhuar në vend që të hapet tregu afatshkurtër të stimulohet zhvillimi i tregjeve me shumicë të energjisë elektrike (meqë shumica e këtyre vendeve janë importues të energjisë elektrike, dhe ata rrallë do të kishin tepricë të energjisë elektrike të gjeneruar);

Së dyti, çmimi i gjenerimit vendor është plotësisht i rregulluar nga autoritetet rregullatore në nivele që nuk mbulon kostot (zakonisht për investimet e ardhshme), që përbën faktor negativ për arritjen e sigurisë afatgjate të furnizimit në këto vende;

Së treti, konsumatorët vendorë (te mëdhenj) të furnizuar me tarifat e rregulluara përfitojnë nga fakti që gjenerimi çmohet/llogaritet në tarifat e rregulluara të vendosura nga entet rregullatore, dhe këta konsumatorë (për të cilët rezervohet energjia elektrike e prodhuar në vend) nuk bëhen përgjegjës për të paguar koston e plotë të prokurimit të gjenerimit në treg të hapur (përfshirë koston për importimin e energjisë elektrike); dhe

Së katërti, kjo strukturë tregu nuk stimulon zhvillimin e konkurrencës në tregun me pakicë sepse nuk ka asnjë incentivë që furnizues të rinj të futen në tregje dhe konsumatorët e kualifikuar nuk kanë ndonjë incentivë që të ndërrojnë furnizues.

Çmimet aktuale të rregulluara të energjisë elektrike për konsum fundor me shumë gjasa nuk janë në përputhje me *acquis* të BE-së dhe të ndihmës shtetërore. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë shënon se çmimet e rregulluara për përdoruesit fundorë (nëse nuk mbulojnë kostot e justifikuar) që aktualisht ekzistojnë në Palët Kontraktuese ka shumë mundësi të përbejnë ndihmë shtetërore të ndaluar, shumë ngjashëm me rastin e Francës dhe të Spanjës. Nëse një ndërmarrje furnizohet me energji elektrike me çmime të ulta të rregulluara, mund të konsiderohet se kjo përbën avantazh sepse ajo përfiton nga çmimet e ulta të rregulluara. Ky duket të jete rasti edhe në të gjitha Palët Kontraktuese aktualisht. Për më tepër, humbjet prej furnizimit me çmime të ulta të rregulluara që i pëson furnizuesi (zakonisht publik) dhe/ose gjeneruesi (zakonisht ekzistues në pronësi shtetërore) të cilit i është besuar Obligimi për Furnizim Publik, mund të duhet gjithashtu të mbulohen nga buxheti i Shtetit në formën e ndihmës shtetërore për furnizuesin publik të energjisë elektrike dhe/ose gjeneruesin publik në fjalë. Dhe në fund, mundësia që u ipet konsumatoreve të kualifikuar, që kanë shfrytëzuar të drejtat e tyre të të qenit të privilegjuar, të kthehen dhe kërkojnë furnizim nga furnizuesi (publik) i konsumatoreve tariforë, me të njëjtat kushte dhe me të njëjtat çmime të rregulluara si përdoruesit fundorë, mund të ngrejë shqetësimin si edhe në rastin Francez<sup>23</sup>.

## **B. Sfidat kryesore drejt tregut konkurrues të energjisë elektrike: Rruga përpara**

Në korrik 2010, studimi rajonal “Hapja e Tregut me Shumicë në Evropën Jug Lindore”, i financuar nga Banka Botërore, parashikoi të gjitha hapat që duhet të ndërmerren së bashku me afatet kohore për hapjen e tregjeve nacionale elektroenergjetike në Palët Kontraktuese deri në 2015. Në këtë Studim është përgatitur një roadmap i qartë edhe për Kosovën.

---

<sup>23</sup> Çmimet e Rregulluara të Energjisë Elektrike në Komunitetin e Energjisë – Gjendja dhe Rekomandime për Reforma”, Raport nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 25 qershor 2012

Të lejohet futje graduale e konkurrencës ne sektorin e gjenerimit. Gjeneruesit ekzistues vendore te energjisë elektrike duhet te lejohet gradualisht të shesin ë tregun afatshkurtër një pjese te energjisë që ata gjenerojnë, kështu që te mund te hapet dhe stimulohet zhvillimi i tregut me shumicë te energjisë elektrike. Çmimi i energjisë elektrike në tregun afatshkurtër duhet te jete plotësisht i derregulluar. “Modeli blerës i vetëm” aktual i tregut elektroenergetik nuk është ne përputhje me *acquis* te BE për energji dhe konkurrencë.

Të shturen efektivisht bizneset e shpërndarjes dhe furnizimit. Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 parashikon shturjen e plote te ndërmarrjeve te sektorit energjetik<sup>24</sup>. Furnizimi dhe shpërndarja nuk janë shturur praktikisht në Kosovë, dhe kjo krijon një ‘fushë loje’ te pabarabarte midis furnizuesit ekzistues dhe atyre te rinj që mund te dëshirojnë te futen ne tregun e furnizimit. Kjo masë, e shoqëruar edhe me obligimin që konsumatorët e mëdhenj te kualifikuar ta blejnë energjinë elektrike që u duhet ne tregun e derregulluar<sup>25</sup> (jo prej furnizuesit publik) do te lehtësojë futjen e konkurrencës dhe përmirësojë likuiditetin e tregut te energjisë elektrike në pak vitet e ardhshme. Shturja e plote e llogarive midis aktivitete te rregulluara dhe atyre jo te rregulluara, si dhe midis gjenerimit/furnizimit dhe shpërndarjes, duhet te kompletohet si një parakusht për te arritur kost-reflektivitet.

Te liberalizohet gradualisht çmimi i energjisë elektrike. Për sa kohë çmimet e rregulluara të përdoruesve fundorë, që janë nën kostot me te cilat përballen furnizuesit e rinj potenciale, janë në dispozicion edhe për konsumatorët e kualifikuar, hapja efektive e tregut do te ishte shume e vështirë te arrihej. Vendosja e çmimeve te përdorimit fundor për konsumatorët tarifore që reflektojnë kostot e transmetimit dhe shpërndarjes, edhe te dy aktiviteteve konkurruese – gjenerimit dhe furnizimit, është njëra prej çështjeve kryesore që duhet te adresohet<sup>26</sup>. Hapi i parë është te sigurohet që çmimet e energjisë elektrike për te gjithë konsumatorët e te njëjtës kategori/klasë te përcaktuar për qëllimet e shërbimit universal siç parashihet ne fjalinë e parë te Nenit 3(3) te Direktivës 2003/54/EC (“amvisëritë dhe ndërmarrjet e vogla dhe te mesme”) që janë subjekt i rregullimit te çmimit, janë kost-reflektive.

Të vendoset një program nacional i dedikuar për mbështetjen e konsumatoreve në nevojë/vulnerabël. Legjislacioni për sektorin e energjisë në Kosovë parashikon

---

<sup>24</sup> Neni 46.6 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë parashikon që Zyra e Rregullatorit për Energji monitoron zbatimin e pajtueshmërisë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe shturjen efektive ligjore dhe të llogarive të ndërmarrjeve të integruara energjetike në pajtim me këtë ligj, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Gazin Natyror, si dhe ligjet tjera në fuqi. Zyra e Rregullatorit për Energji ndërmerr veprimet e duhura të zbatimit përkitazi me programet e pajtueshmërisë dhe shturjes ligjore dhe të llogarive.

<sup>25</sup> Eshte esenciale që heqja e çmimeve te rregulluara per konsumatorët e mëdhenj te shoqërohet me një kërkesë per KEK sh.a. që te shesë nepermjet procedurave konkurruese dhe te publikojë kontratat per transparencë dhe pergjegjshmeri.

<sup>26</sup> Kost-reflektiviteti duhet te shtrihet në koston reale te furnizimit te energjise elektrike, perfshire koston e gjenerimit, reflektimin e koston per prokurimin e energjise elektrike per amviserite dhe konsumatorët tarifore nga gjenerimi vendor dhe nga importi, investimet e nevojshme, nje norme fitimi te pershtateshme, koston e furnizimit dhe borxhet e keqija. Çmimi i gjenerimit vendor nuk duhet te rregullohet në veçanti.

mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë<sup>27</sup>. Strategjia Rajonale e Energjisë për KEn parasheh gjithashtu mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë<sup>28</sup>. Në këtë aspekt, te gjithë anëtarët e KEn obligohen të definojnë qarte (dhe me ligj ose rregullore, si të jetë e përshtatshme për ta) definicionin e konsumatoreve në nevojë që janë subjekt i mbrojtjes dhe mbështetjes së veçantë. Për më tepër, duhet të zbatohen programe nacionale të dedikuara për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë, si edhe programe për të përmirësuar eficiencën e energjisë dhe shtuar përdorimin e burimeve të perteritshme të saj në amvisëri. Midis veprimeve prioritare që duhet të ndërmerren janë edhe vendosja e një kornize rregullatore transparente dhe të qarte, vendosja e standardeve për cilësinë e shërbimit, trajtimi i ankesave të konsumatoreve, dhe shpallja e udhëzimeve të qarta për ndryshimin e furnizuesit të energjisë. Skema mbrojtëse duhet të transferohet nga sektori energjetik në sistemin nacional të mirëqenies.

Një përmbledhje e sfidave për hapjen e tregut të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë (KEN), siç ato identifikohen nga Sekretariati i KEn, vijon.

#### Sfidat për Hapjen e Tregut të Energjisë Elektrike

1. Kompletu procesin e **Shturjes** në të gjitha nivelet
2. Elimino kontratat për **Furnizim të Plotë** midis gjeneratorëve ekzistues dhe furnizuesve publikë
3. Elimino modelin **Blerës i Vetëm** dhe diversifiko burimet e gjenerimit dhe furnizimit
4. Zhvillo platforme komerciale ose të bazuar në treg për **balancimin** dhe shërbimet ndihmese
5. Zhvillo funksionet e **Operatorit të Tregut** dhe settlement-it
6. Fut obligimin për **blerjen e humbjeve** sipas kushteve të tregut
7. Zhvillo një sistem me incentiva për implementim gradual të kriterëve të **kualifikimit**
8. Fut një program, për implementimin e **matjes adekuate** dhe **SCADA**
9. Zbato instrumentet e **monitorimit të tregut** për të eliminuar abuzimin nga dominimi
10. Zhvillo incentiva për të reduktuar **përqendrimin e tregut** dhe nxitur shturjen virtuale të gjenerimit
11. Kompletu zbatimin e kërkesave për **Transparencë** (Rregullorja 1228 e BE)
12. Nxit vendosjen dhe operimin e **tregut për ditën paraprake** (DAM) në kushtet vendore
13. Rikonsidero **çmimet e rregulluara të furnizimit** – shtrirjen dhe nivelin e tyre

*Burimi:* Veprime Lokale si parakusht për hapjen e Tregut Rajonal me Shumicë – *Sfidat dhe Progresi i arritur*, Komuniteti i Energjisë – Forumi i 17-të i Athinës, 27 – 28 qershor 2012, Zt. Simon Uzunov nga Sekretariati i KEn

<sup>27</sup> Nenet 3.6.9 dhe 15.1.4 të Ligjit për Energjinë Nr.03/L –184 parashikojnë mbrojtjen e konsumatorëve vulnerabël (në nevojë).

<sup>28</sup> Kosova duhet të definojë qartë dhe nepermjet legjislacionit nocionin e konsumatoreve vulnerabël që do të jenë subjekt i mbrojtjes apo mbështetjes së veçantë. Ky definim i konsumatorëve vulnerabël duhet të adresojë nevojat reale për mbështetje ekonomike.

## 4. Energjia e Ripërtërishtme

### A. Statusi, progresi dhe planet

Strategjia e Energjisë synon krijimin e një kornize legislative te përshtatshme dhe tregut te favorshëm për nxitjen e zhvillimit te burimeve te ripërteritshme ne Kosovë. Qëllimi është që te krijohet një mjedis miqësor për investime private te ketë sektor. Burimet e ripërteritshme te energjisë (BRE) në Strategji përfshijnë energjinë nga uji, nga era, energjinë gjeotermike, diellore, biomasën dhe biogazin nga përpunimi i mbetjeve rurale dhe urbane. Kosova përdor aktualisht BRE-të, përfshirë disa hidrocentrale te vogla (HCV), një ferme te vogël me erë, dhe biomasën (kryesisht drutë e zjarrit). Rreth 3% e prodhimit total te energjisë elektrike ne 2010 ishte prej BRE, kryesisht prej burimeve energjetike hidrike dhe erës.

Në Raportin e tij e Progresit për Kosovën në vitin 2011 Komisioni Evropian shënon se Kosova duhet te bëjë përpjekje te mëtejshme për te rritur pjesën e BRE-ve në konsumin final te energjisë dhe te marrë masa për te nxitur përdorimin e biokarburanteve në transport.

Kosova ka mundësi te rrisë energjinë prej BRE-ve, përfshirë: (i) gjenerim te energjisë elektrike dhe nxehtësisë prej biogazit, biomasës, dhe energjisë diellore, (ii) gjenerim te energjisë elektrike nga një numër i HCV-ve dhe prej një HC 300 MW në Zhur, dhe (iii) gjenerim i energjisë elektrike nga era. Figura ne vijim tregon potencialin për gjenerim te energjisë elektrike nga BRE në Kosovë. Kjo figurë bazohet ne te dhënat ekzistuese dhe vlerësimet e ZRrE, te cilat tregojnë që deri në vitin 2020 gjenerimi nga BRE-te mund te jete ne nivelin e 2.5 TWh/vit<sup>29</sup>.




Figura: Mundësitë inkrementale për energji elektrike nga BRE-të në periudhën afatmesme (GWh; %)

#### Barrierat për BRE-të ne Ballkanin Perëndimor

Deri më 10 korrik 2012, Planet e Thjeshtuara te Veprimit për BRE-të ishin paraqitur nga Shqipëria, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Moldavia (plotësuar pjesërisht) dhe UNMIK. Kroacia, ne përputhje me obligimet e dakorduara gjate procesit te anëtarësimit, i paraqiti Komisionit Evropian një Plan te Plote Veprimi për BRE-te.

Planet e dorëzuara identifikuan barrierat te konsiderueshme ndaj zhvillimit te centraleve te BRE-ve, te lidhura me procedurat ekzistuese te pa harmonizuara te autorizimit, planifikimit

<sup>29</sup> "Politika për Energji e Ripërteritshme dhe Zhvillimet e Tregut në Kosovë", Nustret Avdiu dhe Ali Hamiti, ZRrE, prill 2011, Kosovë

te lejimit, certifikimit dhe licencimit që janë kryesisht te dizajnuara për projekte të mëdha investimesh në kapacitetet konvencionale gjeneruese, dhe si pasojë jo te përshtatshme për projektet e BRE-ve.

Zakonisht, janë shumë autoritete të involvuara në procedurat administrative dhe te lejimit që duhet të thjeshtohen dhe koordinohen, si dhe te ketë afate kohore të përcaktuara dhe transparente për procesimin e aplikimeve për BRE. Edhe pse janë identifikuar barrierat (që nuk janë të lidhura me kostot) që vonojnë zhvillimin e projekteve nga BRE-të dhe ndikojnë kapacitetin për të tërhequr investitorët e huaj, vetëm Shqipëria planifikoi dhe bëri përpjekje serioze drejt një institucioni 'one-stop-shop' që të merret me të gjitha anët administrative të aplikimeve për projekte BRE.

*Burimi:* Raport mbi Aktivitetet e RE TF në 2012, Komuniteti i Energjisë, qershor 2012

Këshilli i 10-të Ministror i KEn adoptoi Direktivën për BRE-të dhe parashtrori caqet nacionale për BRE 2020 për nëntë Palët Kontraktuese të TKE-së. Caku prej 25% i pjesës së energjisë nga BRE në konsumin final bruto të energjisë në vitin 2020 u adoptua për Kosovën. Pjesa e energjisë nga BRE-te në konsumin final bruto për vitin 2009 ishte 18.9%<sup>30,31</sup>.

Kosova është e angazhuar të plotësojë caqet për përdorimin e BRE-ve të vendosura në Direktivën relevante të BE-se. Po vazhdon puna për zhvillimin dhe adoptimin e legjislacionit dhe kornizës rregullatore relevante që do të mbështet dhe nxit zhvillimin e përsheptuar të BRE-ve. Në 2007, Qeveria e Kosovës vendosi caqet indikative për konsumin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë nga BRE-te dhe bashkëprodhimi për periudhën 2007-2016<sup>32</sup>.

Ligji i Kosovës për Energjinë Elektrike sugjeron përdorimin e feed-in tarifave si dhe përdorimin e Certifikatave të Origjinës ((CeO) si komponentë të skemës mbështetëse për nxitjen e zhvillimit të BRE-E (BRE për prodhim të energjisë elektrike). Eksperiencia ndërkombëtare sugjeron që feed-in tarifat janë veçanërisht efektive në nxitjen e përdorimit të BRE për gjenerim të energjisë elektrike. Investitorët i pëlqejnë feed-in tarifat sepse ato japin siguri në rrjedhën e të ardhurave prej shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga BRE.

Bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ZRrE ka adoptuar një Rregullore gjithëpërfshirëse për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese, Linjave Lidhëse Direkte Elektrike dhe Tubacioneve Direkte. ZRrE ka shqyrtuar disa aplikime që i janë paraqitur për ndërtim të kapaciteteve të reja dhe ka lëshuar një numër autorizimesh paraprake.

Bazuar në parashikimet e legjislacionit për energji në Kosovë, ZRrE ka adoptuar Rregullin për Skemën Mbështetëse për BRE me këto objektiva kryesore: (i) të nxisë mënyrë transparente zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike nga BRE; (ii) të tërheqë investitorët vendore dhe të huaj duke krijuar mjedis tërheqës për

<sup>30</sup> <http://www.energy-community.org>

<sup>31</sup> Përlllogaritjet e Përditësuara të Targetave për BRE 2020 për Palët Kontraktuese të KEn, Sekretariati i KEn, Vjenë, mars 2012.

<sup>32</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2007 "Caqet indikative për konsumin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë nga BRE-te dhe bashkëprodhimi për periudhën 2007-2016" vendos cakun prej 7.78% të energjisë elektrike të prodhuar prej BRE deri në 2016.

te investuar në kapacitete gjeneruese nga BRE; (iii) te mbështesë, ose te paktën te mos pengojë, zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike, në Kosovë ose në nivel rajonal, kur kushtet e sektorit/sectorëve e lejojnë atë; (iv) te jetë kompatibël në pjesëmarrjen e Kosovës në mekanizmin “Projekte të Përbashkëta”<sup>33</sup> me Shtetet Anëtare të BE-së, siç parashihet në Nenin 9 të Direktivës 2009/28/EC; dhe (v) te jetë e thjeshtë dhe kost-efektive në zbatim.

Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë Elektrike të prodhuar nga BRE janë pjesë e politikës dhe incentivave rregullative. ZRrE ka adoptuar gjithashtu: (i) Rregullin për Lëshimin dhe Përdorimin e Certifikatave të Origjinës (CeO) për energjinë elektrike të prodhuar nga BRE, Mbetjet dhe nga Bashkëprodhimi, dhe (ii) Feed-in tarifaf<sup>34</sup>.

Tarifat feed-in të aplikueshme dhe një liste me kërkesat për licencim dhe lejet për BRE janë paraqitur në Shtojcën 5.

Shtetet Anëtare të BE-së ofrojnë një diapazon incentivash për nxitjen e BRE-ve, përfshirë: (i) Feed-in tarifaf, (ii) Kuota dhe Certifikata të Gjelbra të Tregtueshme (CGT), (iii) Studime për investime/grante dhe/ose Përrjashtime nga taksat/kreditë, dhe (iv) Sisteme të tjera. Thënë përgjithësisht, evidenca në dispozicion sugjeron që në vendet e BE-së feed-in tarifaf kanë arritur performancën me të mirë për nxitjen e zhvillimit të BRE-E. Shtojca 6 përmbledh eksperiencën dhe mësimet e nxjerra në vendet e Besë për incentivat për BRE-E.

#### **OPSIONET PËR LICENSIM DHE AUTORIZIM NË KOSOVË**

Një çështje e fundit lidhur me dhënien e lejes për të zhvilluar kapacitet gjenerues BRE-E në një lokacion të caktuar – kushdo që të jetë formati ligjor dhe procedura administrative – është nëse ajo duhet të jetë ose jo objekt i procesit të tenderimit. Për këtë, dy alternativa janë të mundshme: (i) lëshimi i lejes pas paraqitjes së aplikimit, dhe (ii) leja jepet mbi bazën e rezultatit të një procesi tenderues.

Dy konsiderata (të ndërlidhura pjesërisht) duket se janë relevante gjatë vlerësimit të këtyre alternativave: (i) numri i lokacioneve të përshtatshme në dispozicion për zhvillim të gjenerimit nga BRE-E në krahasim me caqet e deklaruara të penetrimit; dhe (ii) diferenca në kostot për zhvillim të BER-E në lokacione të ndryshme.

Nëse lokacionet për zhvillim të kapaciteteve gjeneruese nga BRE-E janë të kufizuara kur krahasohen me kapacitetin e nevojshëm për të arritur caqet e penetrimit, mund të jete e përshtatshme të sigurojmë që këto lokacione përdoren me kapacitet të plote të mundshëm në mënyrën më eficiente, dhe për këtë ato i ipen zhvilluesve / investitorëve / operatoreve të cilët mund të arrijnë përdorimin me të mirë të tyre.

<sup>33</sup> Neni 9 të Direktivës 2009/28/EC parashikon zhvillimin e ‘Projekteve të Përbashkëta’ midis Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve të treta. Projektet e Përbashkëta ofrojnë mundësi të mëtëjshme për zhvillimin e projekteve BRE-E në Kosovë. Edhe pse keto projekte nuk do të perfitojnë nga skema mbështetëse nacionale dhe pra nuk do të përbejnë barrë shtesë në buxhet ose trarifaf, ato jo domosdo kontribuojnë në arritjen e caqeve (indikative) nacionale: kjo varet nga vendimi i autoriteteve të Kosovës. Sidoqoftë menyra se si caqet aktuale janë vendosur – si pjesë e konsumit nacional – dhe fakti që një nga kërkesat për Projekte të Përbashkëta është që një sasi ekuivalente të energjisë elektrike të jete eksportuar për konsum në BE bëjnë me gjasa që ajo energji BRE-E të prodhuar nga Projektet e Përbashkëta nuk do të llogaritet drejt arritjes së targetave të Kosovës për BRE-E.

<sup>34</sup> “Politika për Energjinë e Ripërteritshme dhe Zhvillimet e Tregut në Kosovë”, Nustret Avdiu dhe Ali Hamiti, ZRrE, prill 2011, Kosovë



Një objektiv i tyre mund të arrihet nëpërmjet tenderimit për lejen e zhvillimit të gjenerimit nga BRE-E në lokacione të caktuara të ndryshme. Nëpërmjet këtij procesi, kjo leje do të ipet zhvilluesve / investitorëve / operatoreve të cilët janë të përgatitur të paguajnë rentën (fee) më të lartë, e cila duhet të nënkuptojë se ata pritët të operojnë centralin me eficiencën më të lartë.

Nga ana tjetër, ndërsa diferencat në kostot midis teknologjive të ndryshme të BRE-E mund të adresohen nëpërmjet tarifave të ndryshme për teknologji të ndryshme, diferencat e kostove brenda të njëjtës teknologjie mund të çojnë përfitime të tepërta për ato centrale apo ato lokacione që karakterizohen nga kosto më të ulta. Kështu fitimet e tepërta mund të zvogëlohen, pra njëherësh edhe ngarkesa financiare mbi konsumatorët, nëpërmjet të tenderimit të lejes për zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese prej BRE-E. Nëse ka konkurrence të mjaftueshme për zhvillimin e gjenerimit prej BRE-E, procesi tenderues do të përcaktonte çmime më të larta për lejet e lokacioneve me të mira, duke marrë kështu të paktën një pjesë të 'rentës' së krijuar nga kualiteti superior i tyre.

Ne fund, është e rëndësishme të sigurohet që përdorimi i tenderëve konkurrues për dhënien e lejeve për ndërtim të kapaciteteve gjeneruese nga BRE-E nuk frenon motivimin e zhvilluesve / investitorëve për të kërkuar dhe vlerësuar lokacione të reja. Ky ndikim negativ mund të evitohet duke: (i) lejuar zhvilluesit / investitorët të identifikojnë dhe propozojnë lokacione të reja për zhvillim të BRE-E; (ii) organizuar një proces tenderi për secilin lokacion të identifikuar; dhe (iii) dhënies zhvilluesit/investitorit i cili ka identifikuar dhe propozuar lokacionin, i një "avantazhi" në procesin tenderues, për shembull në formën e një zbritje në rentën/fee-ne që rezulton nëse ai përzgjidhet fitues.

*Burimi:* Korniza Rregullatore për BRE në Kosovë, Përgatitur nga Mercados – EMI, janar 2009

## **B. Sfidat kryesore për zhvillimin e BRE: Rruga përpara**

Tejkalimi i sfidave, përfshirë ato të identifikuar më poshtë, lidhet me zbatimin e Direktivës 2009/28/EC mbi nxitjen e përdorimit të energjisë nga BRE<sup>35</sup> dhe arritjen e qaveve për BRE siç ato për Kosovën janë përcaktuar në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë. Sfidat kryesore përfshijnë:

Incentivat fiskale. Këshillohet reduktimi i doganave dhe taksave për materialet energji-eficiente dhe pajisjet e teknologjive të BRE-ve. Për të arritur këtë qëllim MZHE dhe MF (Ministria e Financave) duhet të punojnë së bashku për të zhvilluar një program adekuat me incentiva fiskale (përfshirë subvencione të dedikuara) në mbështetje të masave dhe projekteve të EE dhe BRE. Kjo do të krijojë një treg të favorshëm për rritjen e EE dhe përdorimin e BRE.

Rishikimi dhe bashkërendimi i proceseve për centralet e vogla të BRE-ve. Në kuadër të zhvillimit dhe zbatimit të Planit të Thjeshtuar të Veprimit për BRE, KEn kërkon nga Kosova të sigurojë që rregullat për autorizimin, certifikimin dhe licencimin janë objektive, transparente, proporcionale dhe jo diskriminuese midis aplikuesve duke marrë parasysh veçantitë e secilës teknologjie të energjive të ripërteritshme. Task Forca për BRE (në kuadër të TKE) i kërkon Kosovës, si dhe të gjithë Palëve Kontraktuese, të rishikojë dhe bashkërendojë proceset për centralet e vogla të RES.

Vendosja e një mekanizmi monitorues të përputhshmërisë për përdorimin e biokarburanteve. Lidhur me biokarburantet, kërkon nga Kosova që të krijojë një

<sup>35</sup> Kjo Direktivë anuloi Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC

mekanizëm nëpërmjet të cilit një operator ekonomik që prodhon apo përdor biokarburante apo biolëngje të mund të tregojë përputhshmërinë e tyre me regjimin e qëndrueshmërisë siç parashihet në Direktivën 2009/28/EC (Nenet 17 dhe 18) duke përdorur provën nga një skeme vullnetare që është e njohur nga Komisioni Evropian.

Krijimi i një institucioni 'one-stop-shop' për projektet BRE. Task Forca për BRE identifikon që janë shumë autoritete të angazhuara në procedurat administrative dhe të lëshimit të lejeve, të cilat duhet të thjeshtohen dhe koordinohen me afate kohore të përcaktuara dhe transparente për procesimin e aplikacioneve për BRE<sup>36</sup>.

Promovimi i njohjes së teknologjive BRE. Agjencia për Eficiencën e Energjisë duhet të jete përgjegjëse për koordinimin e programeve qeveritare, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikës dhe planeve të veprimit për BRE. Kjo Agjenci do të duhet të promovojë njohjen e teknologjive për BRE dhe projekteve konkrete për të gjitha palët e interesuara (qeveri, investitorë, komuna, OJQ, etj.)

Programe dhe opsione për financimin e BRE-ve. Opsionet për financimin e BRE-ve mund të përfshijnë grantet, kreditë ose huatë e buta prej Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, kapital privat vendor dhe i huaj, por dhe burime të tjera si ato në kuadër të Mekanizmit për Zhvillim të Pastër (Clean Development Mechanism – CDM). Meqë huatë do të ishin burimi kryesor për financimin e kompanive të reja që ndërtojnë centrale me BRE, kjo mund të ishte një barrierë për stabilimentet e BRE-ve.

## 5. Eficiencia e Energjisë

### A. Statusi, progresi dhe planet

Niveli aktual i eficiencës së energjisë (EE) në Kosovë është i ulët, dhe është plotësisht e mundur të synohet një rritje prej 20% në EE deri në 2020. Ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re" do të rezultojë me një përmirësim prej rreth 5% të EE në gjenerim, kjo si rezultat i teknologjive moderne që do të përdoren në të, krahasuar me TC Kosova A dhe TC Kosova B. Potenciali më i madh për përmirësimin e EE është në sektorin e ngrohjes dhe atë të gjenerimit, ku aktualisht eficiencia është mjaft nën atë të përcaktuar nga direktivat relevante të BE dhe standardet aktuale në BE për furrat dhe pajisjet e vogla ngrohëse. Për pajisjet shtëpiake ekziston mundësia që EE të rritet me deri në 100%, ndërsa EE në gjenerimin aktual të energjisë termike mund të përmirësohet deri në 40% nëpërmjet teknologjive të reja për gjenerim nga djegia e linjtit. Përmirësime të mëtejshme mund të arrihen duke futur bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë<sup>37</sup>.

Tanimë janë kryer përgatitjet teknike për projektin e bashkëprodhimit në TC Kosova B, për të përdorur mbetjen e nxehtësisë për të prodhuar ngrohje qendrore, duke

---

<sup>36</sup> Përkundër identifikimit të barrierave (pa kosto direkte të identifikuar) që vonojnë zhvillimin e një projekti BRE dhe ndikojnë negativisht kapacitetin për tërheqje të investitorëve të huaj, vetëm Shqipëria planifikoi dhe ka bërë përpjekje serioze drejt një institucioni 'one-stop-shop' për t'u marrë me të gjitha aplikacionet administrative për projekte BRE.

<sup>37</sup> Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018

reduktuar kështu emetimet e CO<sub>2</sub>. Investimi aktual është ne dyshim për arsye te vështirësive financiare te sektorit te ngrohjes qendrore<sup>38</sup>.

Si palë nënshkruese e Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE), Kosova është anëtare e Task Forcës për Eficiencen e Energjisë (TF EE). Nën udhëzimet e TF EE, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka përgatitur Planin e Parë Nacional Te Veprimit për Eficiencen e Energjisë (NEEAP).

#### **Plani Nacional i Veprimit për Eficiencen e Energjisë (NEEAP) 2010-2018**

NEEAP parashtrohet caqet nacionale për kursimin e energjisë për periudhën 2010-2018. Më herët, në 2007, Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) pati përgatitur programin 3-vjeçar te Kosove për EE dhe BRE. Një numër projektesh të këtij programi janë duke u zbatuar.

Objektivi i Kosovës është te arrijë cakun e vendosur prej 9% për kursimin e energjisë deri ne fund te vitit 2018.

Në NEEAP-in e parë për 2010-2012 Kosova ka adoptuar një cak ndërmjetës te kursimit te energjisë prej 3%, ose te kursehen 30.63<sup>39</sup> ktoe prej caktut te përgjithshem prej 1021.08 ktoe për tu kursyer deri në vitin 2020.

NEEAP 2010-2018 vendos caqet afatgjata për EE për periudhën 2010-2018 dhe caqet ndërmjetëse 2010-2012. Në përcaktimin e caqeve afatmesme, NEEAP ka pasur parasysht:

- (i) Mungesën e Agjencisë funksionale për EE dhe atë të Zyrave Rajonale te Energjisë
- (ii) Mungesën e një Fondi për EE
- (iii) Mungesën e sistemit për etiketimin energjetik te ndërtesave
- (iv) Mungesa e procedurës ligjore për obligimin e prokurimit te pajisjeve EE për entitetet publike
- (v) Mungesën e kompanive te shërbimeve energjetike
- (vi) Vonesën ne aplikimin e Etiketimit te Pajisjeve Elektro-Shtëpiake
- (vii) Mungesën e te dhënave te plota për EE nga anketimet e sakta ne sektorin publik
- (viii) Mungesën e vendimit obligues për ndërmarrjen e masave për EE ne entitetet e sektorit publik

*Burimi:* Plani i Eficiences se Energjisë i Kosovës 2010-2018, siç është aprovuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik në 30 shtator 2011

MZHE së bashku me GIZ dhe mbështetur nga Fondi i Hapur Rajonal kanë zhvilluar një metodologji për Monitorimin, Vlerësimin dhe Raportimin e zbatimit te masave te EE.

Ligji për Eficiencen e Energjisë, Nr. 04/L-016, 22.07.2011, parasheh krijimin e Agjencisë së Eficiences së Energjisë. Themelimi i kësaj agjencie si dhe Fondit për EE do

<sup>38</sup> Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit, Kosova\*, 2011; Raport Progresi, Bruksel, 12.10.2011

<sup>39</sup> Ky cak nacional është ndarë mes sektoreve, perfshirë amviserinë, shërbimin, industrinë, transportin, dhe bujqesinë. Kursimet e parapara te energjisë në amvisëria arrijnë në 40% te caktut te përgjithshëm prej 30.63 ktoe që është për t u kursyer gjatë 2010-2012.

te kontribuojnë ndjeshëm në zbatimin e NEEAP-it. Themelimi shpejt i Fondit për EE dhe Agjencisë për EE është i domosdoshëm për zbatim të suksesshëm të NEEAP<sup>40</sup>.

Tarifat e energjisë elektrike në Kosovë janë ndër më të ulëtat në rajon. Përkundër çmimeve të ulëta, mos-pagesa e faturave të energjisë është problemi kryesor në sektor. Ngjashëm me shumë vende të tjera, faturimi për ngrohjen qendrore bazohet në sipërfaqen e hapësirës banesore të konsumatoreve, jo në konsumin e matur. Në Prishtinë, ngrohja qendrore i shërben rreth 20% të popullsisë.

Sipas një studimi të Bankës Botërore, aplikimi i materialeve termoizoluese dhe dritaret me dy xhama do të mundësonte një reduktim të konsumit të energjisë për ngrohje deri në rreth 35% në amvisëritë individuale. Për gjithë Kosovën, kjo do të mundësonte një kursim potencial të ngrohjes në 500-600 GWh/vit, rreth 12 - 14% të kërkesës aktuale për ngrohje.

Me mbështetje nga komuniteti i donatoreve, përfshirë KE, GIZ, etj., Qeveria e Kosovës (QK) ka zbatuar një numër të masave për eficiencë të energjisë në ndërtesa dhe objekte të sektorit publik si shkolla, spitale dhe ndërtesa qeveritare. Ndrichimi eficient i ndërtesave dhe rrugëve dhe izolimi termik janë ndërmjet ndërhyrjeve kryesore. Nga ana tjetër, fushatat për të rritur ndërgjegjësimin publik, që synojnë arritjen e ndryshimit të sjelljes në sektorin amvisnor, kanë qenë një komponent i rëndësishëm i planeve për eficiencë të energjisë.

#### **Modernizimi i shërbimeve komunale**

Gjatë janar 2006 deri në dhjetor 2013, GIZ është duke financuar 1.5 milion Euro në kuadër të një programi investimesh të vogla në fushën e eficiencës së energjisë në nivel komunal, investime këto që bashkëfinancohen nga komunat e Kosovës.

Komunat po ndihmojnë në bashkefinancimin dhe zbatimin e 51 projekteve të vogla duke kontribuar me rreth 50% të fondit të investuar. Shuma maksimale vjetore e secilit projekt dhe komune nuk kalon 40.000 Euro. Investimet përfshijnë: (i) modernizimin e ndriçimit rrugor publik, dhe (ii) rehabilitimin e ndërtesave publike (zëvendësimin e karpenterisë, izolimin termik të mureve të jashtme dhe tavaneve, dhe/ose instalimin e ngrohjes së përqendruar), përmirësimin e sistemeve të ngrohjes, përfshirë instalime të reja.

*Burimi:* Rishikim i Skemave Mbështetëse Financiare në Dispozicion për Eficiencën e Energjisë në Ballkanin Perëndimor, qershor 2011, raport i financuar nga BE, përgatitur nga një Konsorcium i udhëhequr prej PM Group

QK është e angazhuar të futë bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë në TC Kosova B. Në vitin 2011 u kompletua studimi i fizibilitetit për projektin e kombinimit të nxehtësisë dhe energjisë elektrike në Kosovë, ku nxehtësia që humbet prej TC Kosova B do të rikuperohet dhe transmetohet në sistemin e ngrohjes qendrore të Prishtinës. Investimi total i kërkuar për këtë Projekt është vlerësuar në 48.9 milion Euro<sup>41</sup>. Qeveria Gjermane së bashku me Komisionin Evropian kanë angazhuar financimin për këtë projekt të rëndësishëm bashkëprodhimi.

<sup>40</sup> Dokumenti punues i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë: "Sintezë e vlerësimit të Palëve Kontraktuese' Planet e Evprimit për Eficiencën e Energjisë ...", janar 2011

<sup>41</sup> Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), Raporti Vjetor 2011

Disa “pilot-projekte” EE duhet te zbatohen, për te shërbyer si model për ndërhyrje te ngjashme më te gjëra. Disa ndërhyrje prioritare janë identifikuar, dhe pilot-projekte janë zbatuar ose janë gati te zbatohen në te ardhmen e afërt. Tri projektet më premtuese për kursim te energjisë te identifikuara nga studimi i Bankës Botërore për Tregun e Ngrohjes<sup>42</sup> janë: (1) Dritaret e reja për 65% te spitaleve dhe qendrave shëndetësore; (2) Dritaret e reja për 85% te shkollave; dhe (3) Dritaret e reja për 10% te apartamenteve në ndërtesat mbi tri kate (ndërtuar gjate periudhe 1960 – 1998).

Zbatimi i plote i këtyre projekteve për kursim te energjisë pritet te sjelle një kursim prej 72 GWh/vit.

Djegia e drurit për ngrohje është mjaft e përhapur ne Kosovë. Mbi 80% e amvisërive në Kosovë përdorin drutë e zjarrit si burim parësor ose dytësor për ngrohje dhe gatim; mbi gjysma e shkollave përdorin drutë e zjarrit për ngrohje. Stufat efiçente te drurit do te zvogëlonin varfërinë, dhe përmirësonin shëndetin dhe mjedisin. Kosovarët përdorin rreth 2.5 milion m<sup>3</sup> dru zjarri në vit. Dhe, druri kushton rreth €40-50/m<sup>3</sup>. Shumica e stufave që djegin dru janë prodhim i dobët me efiçencë te ulët rreth 15-20%, ndërkohë që stufat me tulla dhe ato me djegie nga poshtë kanë efiçencën prej 50% ose më te lartë.

#### **Programi i Stufave Efiçente te Drurit për Kosovën**

Stufat efiçente do te zvogëlonin për rreth 60% kërkesën totale për dru zjarri, do te zvogëlonin ndotjen e ajrit te brendshëm, dhe do te ngadalësonin normën e shpyllëzimit. Kjo do ta bënte pylltarinë e qëndrueshme një mundësi te realizueshme për vendin.

Një stufë efiçente do te kushtonte rreth €300 nëse prokurohet me shumicë; dhe meqë konsumi vjetor tani është rreth 10 m<sup>3</sup> për amvisëri (4 m<sup>3</sup> në zonat urbane dhe 12 m<sup>3</sup> në zonat rurale), periudha e vetëshlyerjes për konsumatorët do te ishte më pak se dy vite. Qeveria e Kosovës mund te zbatonte një program pilot për te futur stufat efiçente, me synim pajisjen me stufa efiçente te 100,000 konsumatorëve më te varfër.

Kërkesa për energji elektrike për ngrohje shtesë do mund te reduktohej me rreth 3,840 kWh/vit për çdo amvisëri, ose 384 GWh/vit në total e cila tani duhet te importohet në shpenzim te Qeverisë. Një investim prej €30 milion për stufa efiçente është më pak se €38.4 milion kostua për energjinë elektrike te importuar vetëm në vitin e parë dhe do te mundësonte benefite te mëdha për shumë vite në vijim.

*Burimi:* Statusi i Efiçences së Energjisë ne Ballkanin Perëndimor, Një Raport Grumbullues te Dhënash, Banka Botërore, 15 qershor 2010

Financime te mëdha kërkohen për te zbatuar masat për EE dhe arritur caqet e NEEAP. Fondet në dispozicion në nivel rajonal mund te luajnë rol te rëndësishëm në ketë drejtim. Tabela në vijim tregon një përmbledhje te këtyre fondeve<sup>43</sup>. Informacioni i detajuar mbi operimin dhe financimin e fondeve rajonale ipet në Shtojcën 7.

<sup>42</sup> Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018

<sup>43</sup> Rishikim i Skemave Mbështetëse Financiare në Dispozicion për Efiçencën e Energjisë në Ballkanin Perëndimor, qershor 2011, raport i financuar nga BE, përgatitur nga një Konsorcium i udhëhequr prej PM Group

	Nr.	Milion Euro
Rajonal Total	11	592.85
Fondet Rajonale Hua (me asistencë teknike (AT) dhe grante)	8	580.45
Fondet dhe Programet AT Rajonale	3	12.40

Linjat e Kredisë EE janë disa herë mjete eficiente për të arritur segmentet komerciale dhe industriale të tregut. Bankat pjesëmarrëse mund të propozojnë investime EE konsumatoreve ekzistues, të financuara prej linjave të kredisë. Ajo që duhet të mbahet parasysh në këtë rast është që linjat e kredisë duhet të shoqërohen me trajnim për bankat participuese dhe fushatë marketingu efektive. Përdorimi i fondeve grant për të paguar përgatitjen e projekteve dhe auditimet energjetike, për të zbutur kështu termat e huave, është një parakusht.

## **B. Sfidat kryesore për të avancuar eficiencën e energjisë: Rruga përpara**

Kompletimi i kornizës ligjore dhe rregullatore. Kosova duhet të vazhdojë të komplotojë kornizën ligjore dhe rregullatore në fushën e eficiencës së energjisë siç kërkohet në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE). NEEAP parasheh detajet për këtë qëllim.

Zhvillimi i institucioneve për nxitje dhe monitorim të eficiencës së energjisë. Kosova duhet të funksionalizojë Agjencinë për EE siç parashihet në Ligjin për Eficiencën e Energjisë, Nr. 04/L-016, 22.07.2011. Roli dhe përgjegjësitë e kësaj Agjencie janë përshkruar qartë edhe në Rregulloren e MZHE Nr.08/2011 “Mbi Organizimin e Brendshëm të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë”. Edhe pse Ligji për EE nuk parasheh krijimin e një Fondi për Eficiencën e Energjisë (Fondi për EE), Qeveria e Kosovës duhet të konsultohet me komunitetin e donatorëve mbi këtë çështje dhe të vendosë në mënyrë të përshtatshme<sup>44</sup>. Shtojca 8 paraqet informacion mbi rregullimet ligjore dhe institucionale për fushën e EE në disa vende të BE-se dhe të Ballkanit.

Nga ana tjetër, do të ishte e përshtatshme të krijoheshin zyrat e energjisë në nivel komunal. Të gjitha komunat e Kosovës hane departamente të dedikuara në çështje të zhvillimit lokal, përfshirë infrastrukturën lokale. Mandatimi i përgjegjësisë për tu marrë me çështje të energjisë u mungon këtyre departamenteve<sup>45</sup>. Ligji për Energjinë parasheh mundësinë e krijimit të zyrave të energjisë në nivel komunal. MZHE është e

<sup>44</sup> Shumë nga masat për EE kërkojnë investime me periudhë shlyerje më të gjatë se sa shihet e pranueshme nga konsumatorët. Mes aktiviteteve të tjera, Fondi për EE mund të japë subvencione për zbatimin e investimeve për EE, duke shkurtuar periudhën e shlyerjes, si dhe të ndihmojë në mundësimin e normave të interesit më të vogla se ato të tregut atje ku është e nevojshme. Fondi EE është i dobishëm kur fokusohet në segmente të tregut që nuk synohen nga bankat komerciale. Në fillim, fondet EE kanë nevojë për financim grant nga fondet globale të mirëbesimit si GEF, donatorët bilateralë, dhe buxhetet nacionale. Kur një segment i tregut është mjaftueshëm i zhvilluar për të tërhequr financime komerciale, atëherë është arritur qëllimi i Fondit EE dhe ai mund të largohet gradualisht brenda/deri në periudhën afatmesme.

<sup>45</sup> Decentralizimi politik dhe i pronësisë së aseteve dhe burimeve është në nivel të avancuar në Kosovë. Por, në rrugën e saj drejt integritit Evropian, Kosova do duhet të decentralizojë më tej funksionet e buxhetit dhe zhvillimit ekonomik. Ky proces do duhet të shkojë paralel me zhvillimin institucional të komunave dhe kapaciteteve të tyre për të planifikuar zhvillimin dhe mbledhur në mënyrë adekuate të ardhura vendore.

përgatitur te ofrojë trajnim dhe mbështetje tjetër për zhvillim institucional ashtu që këto zyra krijohen dhe funksionalizohen brenda një periudhe te arsyeshme kohore. Disa donatorë, si Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ZNKE) dhe GIZ i Gjermanisë, kanë financuar në te shkuarën aktivitete trajnimi për zyrtarët komunalë. Shtojca 9 paraqet arsye shtesë mbi nevojën për krijimin e zyrave komunale te energjisë.

Zhvillimi në vazhdimësi dhe i gjithanshëm i qëndrueshëm dhe mbajtja e stafit te kualifikuar në te gjitha nivelet e qeverisë është një sfidë e madhe për institucionet e sektorit energjetik në Kosovë.

Mbështetje e mëtejshme e gjithanshme për zhvillimin te institucioneve dhe infrastrukturës për auditimin energjetik si dhe për krijimin e bizneseve te ESCO-ve<sup>46</sup> duhet te jete pjesë e zhvillimit institucional në fushën e eficiences së energjisë në Kosovë. Veprimet respektive te parapara në NEEAP duhet te ndërmerren.

Zhvillimi i një sistemi te dhënash gjithëpërfshirëse për energjinë. Zhvillimi i sistemeve për mbledhjen dhe raportimin e te dhënave në përputhje me EUROSTAT është një prej kërkesave për futje ne BE. BE-ja, nëpërmjet KEn, ka angazhuar agjencitë e saj relevante për te dhënë mbështetje teknike substanciale për krijimin e sistemeve adekuate te statistikave energjetike në vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu që te mund te zhvillohen indikatorët e dobishëm te eficiences se energjisë dhe te monitorohet progresi i arritur.

Dhënia e incentivave. Incentivat mund te ndihmojnë ne tejkalimin e barrierave ndaj hyrjes ne treg, për shembull, nëpërmjet programeve speciale që ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare, ose bile edhe përjashtime te përkohshme nga procedurat administrative standarde. Incentivat duhet te jenë si te llojit shtytës te kërkesës ashtu edhe te ofertës. Shembuj te incentivave shtytës te kërkesës janë ato te futjes se kodeve dhe standardeve që krijojnë ndërgjegjësimit tek përdoruesit fundorë, dhe që bëjnë te mundur financim koncesionar (me lehtësira). Masa nga ana e ofertës përfshijnë veprime si dhënia e incentivave nëpërmjet taksave dhe financimit për ndërmarrjet, duke reduktuar kufizimet e importit dhe taksat doganore për importimin e pajisjeve energji-efiçiente, trajnimin e auditorëve, arkitektëve dhe kontraktorëve, etj.

Heqja e barrierave. Siç identifikohen nga Banka Botërore, barrierat kryesore përfshijnë: (i) kornizat jo-adekuate ligjore dhe rregullatore, (ii) mungesa e incentivave te te gjitha llojeve, (iii) trajnimi dhe 'know-how' janë te pamjaftueshme, (iv) kostot e larta te investimeve për teknologjitë energji-efiçiente, (v) kodet moderne te ndërtimit dhe standardet e EE për makineritë dhe pajisjet duhet te futen dhe zbatohen, (vi) fondet për EE duhet te krijohen, (vii) fushata te targetuara te informimit duhet te lansohen, dhe (viii) çmimet e energjisë janë te ulta dhe ndër-subvencione, ndërkohë mos-pagesa është një çështje sinjifikante. Një përmbledhje e barrierave sipas Bankës

---

<sup>46</sup> ESCO-t (Kmpanitë e Shërbimeve Energjetike) janë kompani te sektorit privat që veprojnë si ndërmjetëse financiare për te zbatuar masat e eficiencës në emër te klientëve nga sektori publik. Për te mund te jenë te mundshme financime preferenciale nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare, veçanërisht nëse ato operojnë kontrata performance te energjisë me klientet e tyre nga sektori publik, duke ndarë kursimet.

Botërore për avancimin e efciences se energjisë ne Ballkanin Perëndimor paraqitet në Shtojcën 10.

Vazhdimi i udhëheqjes nëpërmjet shembullit dhe avancimi i ndërgjegjësimit publik mbi efciencen e energjisë. Edhe pa përmirësime te menjëhershme në sistemet e te dhënave, strukturat e tarifave, dhe nivelet e tarifave, shumë mund te bëhet për te rritur EE. Së pari, sektori publik duhet te vazhdoje te udhëheqë duke futur masa për kufizim te kërkesës për energji në te gjithë stokun e ndërtesave te tij ekzistuese dhe te ato reja ë te ardhmen. Duhet te vazhdohen fushatat për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe që kërkojnë te ndryshohet sjellja ndaj energjisë ne sektorin amvisnor (banesor dhe transport). Së dyti, QK duhet te përpiqet te përshpejtojë zbatimin e Projektit te bashkëprodhimit në TC Kosova B. Së treti, fillimi i programeve për futjen e stufave efçiente me dru, veçanërisht për te varfrit, mund te konsiderohej si pjesë e programit te sektorit publik, ashtu si edhe programet e ndriçimit eficient. Te gjitha këto përpjekje duhet te shoqërohen nga një angazhim dhe veprime te fuqishme për te eliminuar shtrembërimet në çmimet e energjisë dhe rritje graduale te çmimeve te energjisë në nivele qe ati ti mbulojnë kostot për ti mundësuar konsumatorëve zgjedhje racionale mes opsioneve për investime në EE.

Financimi i masave te EE në sektorin publik. Në sektorin publik ekziston potencial i madh për kursim te energjisë, realizimi i te cilit, nëse synohet te arrihen caqet, kërkon marrjen e huave në shuma substanciale prej sektorit publik. Shumica e fondeve aktualisht te mundshëm për tu mobilizuar janë te orientuar në huamarrje prej sektorit privat me fokus kryesor tek amvisëritë dhe ndërmarrjet e vogla dhe te mesme (NVM). Kjo nënkupton se fondet dhe mekanizma te tjera duhet qe gjithnjë e me shume te fokusohen në shërbimet komunale dhe ndërtesat publike. Kapaciteti huamarrës i sektorit publik ne nivel komunal dhe nacional është shume i kufizuar dhe prandaj kërkohet te bëhen përpjekje për te gjetur modele alternative që lejojnë financimet te vihen në dispozicion te sektorit publik.

Programi për Rehabilitimin e Ndërtesave Publike në nivel Nacional. Shumë ndërtesa te administratës, sektorit shëndetësor dhe arsimor janë në kontroll shtetëror dhe mund te përdoren për demonstruar përmirësimet te EE si dhe për te krijuar bazën për një industri vendore shërbimesh qe realizon auditime energjetike dhe zbaton projekte, mbase e mbështetur me grante dhe hua nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFN). Kjo masë/program mund te bashkërendohet shume mire me zhvillimin e politikave te prokurimit publik që mundësojnë shërbimet energjetike. Lejimi i ofertave ‘te gjitha në një’ për pajisje, shërbime, dhe garanci për kursime te energjisë, do te mundësonte kontraktim eficient për rehabilitime/përmirësime për EE të ndërtesave. Një model i mundshëm është kontraktimi ESCO, i cili zakonisht paketon pajisje, shërbime, dhe garancitë te performances për kursim te energjisë, nëse kështu kërkohet<sup>47</sup>. Qeveria, me ndihmë nga donatorët, duhet te konsiderojë

---

<sup>47</sup> Modele më pak gjithpërfshirëse mund te konsiderohen, dhe ato mund te jenë më te përshtatshme. Bashkimi i shumë rehabilitimeve te ndërtesave në një pakto prokuruese do te çonte në ‘economy of scale’ dhe tërhiqte interes më te madh nga ofertesit. Ky lloj projekti do te nxiste kërkesën për shërbime energjetike dhe do te tërhiqte në tregun e EE furnizuesit e pajisjeve, shitësit, dhe kontraktorët vendor dhe ndërkombëtar.



modifikimin e politikës së saj nacionale të prokurimit për të mundësuar kontraktimin e shërbimeve energjetike<sup>48</sup>.

## 6. Siguria Nukleare dhe Mbrojtja nga Rrezatimi

### A. Statusi, progresi dhe planet

Agjencia Kosovare për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Nukleare (AKMRSN) u themelua në 21.06.2011<sup>49</sup>.

Masat për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri nukleare janë pjesë e kërkesave të KE-së në rrugën drejt integritetit Evropian. Nga ana tjetër, Kosova duhet të plotësojë obligimet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguri nukleare, ashtu siç ato definojnë nga Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike (ANET).

Objektivat e AKMRSN përfshijnë<sup>50</sup>: (i) krijimin e bazës ligjore dhe harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me standardet e BE-së dhe të Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike (ANET); (ii) ratifikimi i konventave ndërkombëtare në fushën e sigurisë atomike; (iii) mbikëqyrja e operatorëve që përdorin burime radioaktive ose substanca atomike, angazhojnë burime ose transportojnë materiale nukleare; dhe (iv) krijimin e kushteve mbrojtjen e përgjithshme të shëndetit dhe mjedisit nga veprimet e dëmshme të rrezatimit, dhe plotësimin e obligimeve në fushën e sigurisë nukleare.

AKMRSN është duke i kompletuar dhe po fillon të funksionojë, me synimin që të aftësohet për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligj. AKMRSN planifikon të plotësojë bazën ligjore dhe rregullatore, ashtu që të fillojë aktivitetet e licencimit dhe inspektimit të cilat do të sigurojnë mjedis të sigurt për jetë të shëndetshme në vend.

AKMRSN përballlet me përgatitjen e pjesëve të reja të legjislacionit dhe rregullave në përputhje me *acquis* të BE-së.

### B. Sfidat kryesore: Rruga përpara

Janë identifikuar sfidat e mëposhtme për avancimin e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurinë nukleare në Kosovë:

1. Nevojitet transpozimi i mëtejshëm i *acquis* për fushën e sigurisë nukleare dhe mbrojtjes nga rrezatimi
2. Nevojitet zhvillimi i një plani nacional për emergjencë si dhe një strategji për menaxhimin e mbetjeve radioaktive

<sup>48</sup> Statusi i Efikasitetit të Energjisë në Ballkanin Perëndimor, Një Raport Grumbullues të Dhënash, Banka Botërore, 15 qershor 2010

<sup>49</sup> Ligji për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Nukleare, Nr. 2011/04-L-067, promulguar nga Decreti i Presidentit të Republikës së Kosovës Nr.DL-028-2012, datë 08.06.2012

<sup>50</sup> <http://mmpn.rks-gov.net/?cid=2,54,195>

3. Nevojitet te bashkërendohen funksionet e AKMRSN me organizatat simotra ne BE
4. Nevojitet përfshirja ne konventat ndërkombëtare mbi sigurinë nukleare dhe krijimi i një organi te përshtatshëm rregullator

Kosova duhet te zhvillojë një plan nacional për emergjenca dhe një strategji për menaxhimin e mbetjeve radioaktive me fokus në planifikimin për:

1. Transpozimin e *acquis* te BE për sigurinë nukleare dhe mbrojtjen nga rrezatimi<sup>51</sup>, dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare, përfshirë rishikimin dhe amendimin e Ligjit për mbrojtjen kundër rrezatimit jo-jonizues dhe jonizues dhe sigurinë nukleare,
2. Zhvillimin e rregullave te zbatueshme dhe librave udhëzues ne përputhje me *acquis* te BE,
3. Avancimin e zhvillimit institucional dhe operacionalizimin e AKMRSN, përfshirë avancimin e kapaciteteve administrative dhe furnizimin e pajisjeve vlerësuese, dhe
4. Ndërmarrjen e aktiviteteve te kërkuara për tu përfshirë në konventat ndërkombëtare për sigurinë nukleare dhe krijimin e një organi te përshtatshëm rregullator.

Qëllimi afatmesëm për Kosovën duhet te jete përgatitja e AKMRSN për te përmbushur përgjegjësitë e saj, përfshirë inspektimin dhe monitorimin siç ngarkohet me Ligj.

---

<sup>51</sup> Direktivat EURATOM te cilat në veçanti përmbledhin kërkesat lidhur me përdorimin e radionuklideve për një numër aplikacionesh në sektorin mjeksor dhe në industri.

## Bibliografia

1. Ligjet për energji, mjedis, konkurrencë, naftën dhe mbrojtjen nga rrezatimi
2. Energjia e Strategjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018
3. Plani i Kosovës për Efiçencën e Energjisë 2010-2018
4. Plani i Parë i Maqedonisë për Efiçencën e Energjisë 2010-2018
5. Hapja e Tregut me Shumicë në Evropën Jug Perëndimore, Poyry & Nord Pool Consulting, korrik 2010
6. Pa drita? Parashikimi për Energjinë në Evropën Lindore dhe Ish Bashkimin Sovjetik, Banka Botërore 2010
7. Strategjia e Energjisë e Komunitetit të Energjisë, 18 tetor 2012
8. Komunikimi prej Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012, Bruksel 12.10.2011
9. Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit, Kosova\*, 2011; Raport Progresi, Bruksel, 12.10.2011
10. Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018
11. Deklarata e Sigurisë së Furnizimit për Kosovën (Energji elektrike, Gaz Natyror dhe Naftë), ZRrE, korrik 2011
12. Bilanci i Energjisë në Kosovë për 2011
